



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja a) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit e akteve të komunës, dhe nenit 64 paragrafët 3 dhe 4, ndërlidhur me nenet 14, 15 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 - 2023 në Komunën e Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në propozim të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2022, miratoi këtë,

VENDIM PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në diskutim publik:

- *Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal-SZHEL 2023 / 2025 e Komunës së Podujevës*

Neni 2

Diskutimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej **05 tetor 2022 deri më 05 nëntor 2022**, brenda së cilës Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik mund të organizoj diskutime dhe konsultime të ndryshme, kurse Debatit publik me qytetarë mbahet më **13 tetor 2022** duke filluar nga ora **13:30**, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; mimoze.restelica@rks-gov.net; të cilat pastaj përcjellën në Drejtorinë përkatëse, brenda periudhës së diskutimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik)

Neni 5

Diskutimi/debatit publik zbatohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, dhe përkujdeset për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debatit publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimi ose mospranimi të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 01-300/01-0084085/22
Podujevë, datë, 29.09.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E PODUJEVËS

**DRAFT STRATEGJIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK LOKAL PËR
KOMUNËN E PODUJEVËS
2023-2025**

Shtator, 2022



KOMUNA E PODUJEVËS

**DRAFT STRATEGJIA ZHVILLIMORE LOKALE
PËR KOMUNËN E PODUJEVËS
2023-2025**


Shtator, 2022



Përgatitja e këtij dokumenti është bërë nga ALBO GROUP në partneritet dhe financuar nga Komuna e Podujevës

Autoriteti kontraktues: Komuna e Podujevës

Hartoi: ALBO GROUP në bashkëpunim me Komunën e Podujevës



PËRMBAJTJA

Lista e tabelave.....	VIII
Lista e grafikëve	IX
Lista e figurave.....	X
Lista e shkurtesave.....	XI
<i>Hyrje</i>	13
1. Metodologjia	15
2. Analiza e gjendjes aktuale dhe sfidat	17
Historik i shkurtër i komunës.....	17
Pozita dhe veçoritë gjeografike.....	18
Popullsia	22
Vendbanimet.....	26
Migrimi.....	30
Arsimi	31
Shëndetësia	35
Mirëqenia sociale	38
Tregu i punës.....	39
Shërbimet administrative.....	41
Infrastruktura	42
Telekomunikacioni.....	46
Rrjeti energjetik.....	47
Ndriçimi publik.....	48
Furnizimi me ujë.....	49
Kanalizimi.....	50
Mbeturinat.....	51
Kultura	51
Profili ekonomik i komunës së Podujevës.....	56
Buxheti komunal.....	62
3. Analiza SWOT	66

4. Vizioni, qëllimet dhe objektivat për zhvillim ekonomik.....	68
Vizioni, misioni dhe vlerat kyçe.....	68
Qëllimet strategjike dhe objektivat specifike.....	70
Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të strategjisë.....	85
Ndikimi financiar i zbatimit të strategjisë.....	85
<i>Shtojca 1 - Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal</i>	86
<i>Shtojca 2 - Struktura organizative e komunës së Podujevës</i>	110
<i>Shtojca 3 - Harta e të dhënave bazë</i>	111
<i>Shtojca 4 - Harta e infrastrukturës publike dhe sociale - Arsimi</i>	112
<i>Shtojca 5 - Harta e infrastrukturës publike dhe sociale - Shëndetësia</i>	113
<i>Shtojca 6 - Harta e infrastrukturës teknike mbi mbulueshmërinë me rrjetin e energjisë elektrike, telekomunikimit dhe ndriçimit publik</i>	114
<i>Shtojca 7 - Harta e infrastrukturës teknike - Ujësjetësi</i>	115
<i>Shtojca 8 - Harta e infrastrukturës teknike - Kanalizimi</i>	116
<i>Shtojca 9 - Harta e infrastrukturës teknike - Mbulueshmëria me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave</i>	117
<i>Shtojca 10 - Harta e infrastrukturës publike dhe sociale - Kultura, sporti dhe rekreacioni</i>	118
<i>Shtojca 11 - Harta e zonave dhe sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore</i>	119
<i>Shtojca 12 - Harta zonale e shfrytëzimit të tokës bujqësore</i>	120
<i>Shtojca 13 - Harta zonale e shfrytëzimit të tokës pyjore</i>	121
<i>Shtojca 14 - Harta e zonave turistike</i>	122

Lista e tabelave

Tabela 1. Popullsia e komunës së Podujevës sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare	28
Tabela 2. Klasifikimi i vendbanimeve në komunën e Podujevës	29
Tabela 3a. Migrimi kombëtar në komunën e Podujevës, periudha 2019-2021	31
Tabela 3b. Migrimi ndërkombëtar në komunën e Podujevës, periudha 2019-2021	31
Tabela 4. Rangimi i grupeve kryesore të shkaqeve të vdekjes në Komunën e Podujevës, 2018-2019	38
Tabela 5. Organizimi administrativ në komunën e Podujevës	41
Tabela 6. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe shuara sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike, 2020	58
Tabela 7. Burimet e financimit në komunën e Podujevës (€), periudha 2023-2025	63
Tabela 8. Planifikimi i të hyrave vetanake në komunën e Podujevës (€), 2023-2025	64
Tabela 9. Struktura e shpenzimeve buxhetore në komunën e Podujevës (€), vlerësim për periudhën 2023-2025	64

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Popullsia në komunën e Podujevës sipas regjistrimeve, periudha 1948-2011	22
Grafiku 2. Shtimi natyror në komunën e Podujevës, periudha 2019-2021.....	23
Grafiku 3. Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Podujevës.....	24
Grafiku 4. Struktura etnike e popullsisë në komunën e Podujevës	24
Grafiku 5. Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Podujevës	25
Grafiku 6. Struktura moshore e popullsisë në komunën e Podujevës.....	26
Grafiku 7. Kategorizimi i vendbanimeve në komunën e Podujevës.....	29
Grafiku 8. Regjistrimi i popullsisë sipas vendbanimeve, 1948-2011	30
Grafiku 9. Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare në komunën e Podujevës, 2015-2021	37
Grafiku 10. Krahasim i numrit të vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas kategorive, 2019- 2020	36
Grafiku 11. Statistikat e tregut të punës, 2020, në Republikën e Kosovës.....	39
Grafiku 12. Rrjeta e rrugëve në komunën e Podujevës.....	44
Grafiku 13. Ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet në komunën e Podujevës.....	46-47
Grafiku 14. Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës në komunën e Podujevës.....	57
Grafiku 15. Shfrytëzimi i tokës në komunën e Podujevës.....	59
Grafiku 16. Mesatarja e burimeve të financimit në komunën e Podujevës (%), periudha 2023-2025..	63
Grafiku 17. Struktura mesatare e shpenzimeve në komunën e Podujevës (%), vlerësim për periudhën 2023-2025	65

Lista e figurave


Figura 1. Struktura e përmbledhur organizative e komunës së Podujevës	12
Figura 2. Metodologjia e punës	15
Figura 3. Pozita gjeografike e komunës së Podujevës	19
Figura 4. Pamje e qytetit të Podujevës	27
Figura 5. Disa gjetje në lokalitetin arkeologjik të Vindenisit	53
Figura 6. Koka antropomorfe e modeluar nga balta e përpunuar dhe e pjekur, e zbuluar në Surkish (gjetje rastësore)	55
Figura 7. Liqeni i Batllavës.....	61
Figura 8. Vlerat kyçe të komunës së Podujevës	69

Lista e shkurtesave

AMF	Ambulanca të Mjekësisë Familjare
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
Ha	Hektarë
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
km	Kilometër
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
kv	Kilovat
m	Metër
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit – Asociimit
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
PSAK	Planit Strategjik i Arsimit në Kosovë
PKVEE	Plani Komunal i Veprimit për Efiçencën e Energjisë
QKMF	Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendër e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SWOT	<i>Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats</i>
SZHEL	Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal
SHFMU	Shkolla fillore të mesme të ulëta
SHML	Shkolla të mesme të larta
TM	Tremujor

Struktura organizative e komunës së Podujevës

Fig. 1 Struktura e përmbledhur organizative e komunës së Podujevës*



* Struktura e detajuar organizative është bashkëngjitur në shtojcën nr. 2.

HYRJE

Zhvillimi ekonomik lokal është pjesa qendrore e qeverisjes vendore zhvillimore. Është proces që bashkon partnerë të ndryshëm në zonën lokale për të shfrytëzuar burimet për rritje të qëndrueshme ekonomike. Nëpërmjet këtij procesi, sektori publik, bizneset dhe shoqëria civile kontribuojnë në krijimin e kushteve më të mira. Përveç tjerash ky proces fokusohet në krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e të ardhurave, zvogëlimin e varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës për të gjithë qytetarët pa dallim.

Zhvillimi ekonomik lokal po shihet gjithnjë e më shumë si funksion kyç i qeverisjes vendore dhe mjet për të siguruar që autoritetet lokale dhe rajonale të mund të trajtojnë nevojat prioritare të qytetarëve vendas në një mënyrë të qëndrueshme.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal kërkon qasje strategjike. Gjithashtu kërkon shfrytëzimin dhe mobilizimin e resurseve njerëzore, financiare dhe natyrore drejt vizionit, qëllimeve dhe objektivave të përbashkëta që komuniteti dëshiron t'i arrijë. Kjo është e mundur vetëm kur të gjithë palët e interesit bashkëpunojnë për të bërë ndryshime pozitive në cilësinë e jetesës së tyre.

Qëllimet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal në komunën e Podujevës për periudhën 2023-2025 janë: zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i ambientit të të bërit biznes dhe aktiviteteve bujqësore, zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe mirëqenies sociale, zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i urbanizmit dhe infrastrukturës teknike, zhvillimi i turizmit nëpërmjet promovimit të kulturës dhe mjedisit të pastër jetësor dhe zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i funksionalitetit dhe efikasitetit të shërbimeve komunale.

Duhet theksuar se ky dokument strategjik është hartuar duke u bazuar në udhëzuesin "*Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023*", përgatitur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, ku në mënyrë të precizuar përcaktohet edhe fusha e zhvillimit ekonomik lokal.¹

¹ Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023, fq. 4.

Qeverisja lokale, e cila tani po kalon në vetëqeverisje me tendenca të konsolidimit të autonomisë lokale për komunat dhe thellimit të reformave në sistemin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, po hyn në fazën më të rëndësishme të funksionalizimit të saj. Në kuadër të strategjisë për vetëqeverisje lokale janë paraparë gjithsej 5 objektiva, e para nga to është *fuqizimi i rolit të komunave si akterë kryesorë në zhvillimin ekonomik lokal*⁷

Padyshim, plani strategjik për zhvillimin ekonomik lokal është gur themel i zhvillimit të qëndrueshëm. Andaj, plani strategjik për zhvillim ekonomik lokal është dokumenti kryesor strategjik për mbështetjen e vendimmarrjes në nivel komunal.

Komuna e Podujevës ka si vizion të saj të bëhet komunë që ofron mirëqenie të qëndrueshme për të gjithë qytetarët e saj, pa dallim. Vizioni dhe nismat strategjike që janë prezantuar në vijim, kërkojnë angazhim dhe përkushtim në mënyrë që të realizohen sipas planit strategjik.

Misioni i planit strategjik të komunës është të ofrojë shërbime administrative efikase për qytetarët e saj. Të zhvillojë ekonomiksht komunën e Podujevës në mënyrë që të ulët shkalla e papunësisë dhe varfërisë. Të ofrojë sistem të avancuar arsimor, shëndetësor dhe të sigurojë mirëqenie sociale për qytetarët e saj. Të përmirësojë dhe zhvillojë tutje infrastrukturën teknike në vendet urbane dhe rurale. T'i ruajë dhe t'i mbrojë vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Kështu, vazhdimisht të përmirësojë cilësinë e jetesës së qytetarëve të saj.

Suksesi përfundimtar dhe realizimi i qëllimeve të parashtruara mbështetet në kreativitetin e institucioneve dhe aktorëve vendorë si autoriteteve lokale, operatorëve të sektorit joformal, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile, në përshtatjen e mjeteve me realitetet në terren dhe përdorimin e këtij dokumenti strategjik si dokument jetese, duke e pasuruar atë me ide, njohuri dhe përvoja të reja. Rrjedhimisht, realizimi i qëllimeve të parashtruara për periudhën pesë-vjeçare 2023-2025 në këtë plan strategjik, kontribuon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së jetesës në komunën e Podujevës.

⁷ Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 6.

1. METODOLOGJIA


Zhvillimi ekonomik lokal inkurajon sektorin publik dhe atë privat, si organizatat e shoqërisë civile për të krijuar partneritete dhe për të bashkëpunuar në zgjidhjen e sfidave të përbashkëta ekonomike. Andaj, gjatë procesit të hartimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal (në vijim mund ta gjeni si shkurtesë SZHEL) për komunën e Podujevës për periudhën 2023-2025, janë përfshirë: sektori publik (zyrtarë të drejtorive përkatëse të komunës), sektori privat dhe shoqëria civile. SZHEL mbështetet me projekte konkrete për arritjen e qëllimeve zhvillimore të cilat reflektojnë aspiratat e të gjitha palëve të interesit në komunën e Podujevës.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Podujevës (2023-2025) bazohet në politikat strategjike në vijim:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021;
- Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023;
- Programin Kombëtar për Zbatim të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MS);
- Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe;
- Strategjitë e Veprimit në Nivel Lokal.

Metodologjia e punës së hartimit të SLEZH-it për komunën e Podujevës është prezantuar në vijim:

Fig. 2 Metodologjia e punës



Gjatë procesit të hartimit të SZHEL janë organizuar takime të rregullta pune me përfaqësuesit e komunës së Podujevës. Tutje janë identifikuar palët kryesore të interesit. Të tillët janë konsultuar dhe përfshirë në proces të punës. Në vazhdim është planifikuar procesi i hartimit të këtij dokumenti. Më pastaj janë mbledhur të dhënat nga burimet dytësore mbi veçoritë gjeografike dhe demografike, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, tregun e punës, infrastrukturën, telekomunikacionin, rrjetin energjetik, furnizimin me ujë të pijshëm, shërbimet administrative të komunës, kulturën dhe profilin ekonomik lokal të komunës së Podujevës. Dokumenti është plotësuar dhe pasuruar edhe me të dhëna nga burimet parësore (janë realizuar intervista të strukturuar dhe jo strukturuar si dhe fokus grupe).

Veçanërisht është konsultuar komuniteti biznesor lidhur me pengesat dhe sfidat e tyre në të bërit biznes. Brengat, sugjerimet dhe rekomandimet e tyre për lehtësim, janë përfshirë në një kornizë të veçantë në mënyrë që të merren parasysh gjatë përcaktimit të prioritetëve zhvillimore.

Duke u bazuar në burimet parësore dhe dytësore, është vlerësuar niveli i zhvillimit aktual ekonomik dhe lokal. E gjithë kjo është përfshirë në analizën SWOT e cila pasqyron forcat, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e identifikuar.

Duke u bazuar në rezultatet e analizës SWOT, tutje është definuar plani i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal. Po ashtu është përcaktuar deklarata e vizionit dhe misionit të komunës. Në vazhdim janë vendosur qëllimet dhe objektivat parësore të komunës së Podujevës, duke vazhduar me degëzimin e tyre në programe dhe projekte konkrete.

Dokumenti ka kaluar procedurat e konsultimit paraprak dhe të konsultimit publik, sipas rregullave për hartimin e dokumenteve strategjike në Republikën e Kosovës.

2. ANALIZA E GJENDJES SOCIO-EKONOMIKE

Në këtë pjesë janë prezantuar informata mbi gjendjen socio-ekonomike në komunën e Podujevës. Konkretisht, informata mbi pozitën dhe veçoritë gjeografike të komunës, popullsinë, vendbanimet, migrimin, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, shërbimet administrative, infrastrukturën, telekomunikacionin, kulturën etj. Në vazhdim është prezantuar buxheti komunal dhe profili ekonomik i komunës.

HISTORIK I SHKURTËR I KOMUNËS – Treva Llapit është herët e banuar për shkak të kushteve të volitshme natyrore. Edhe pse shumë monumente që e dokumentojnë vjetërsinë janë zhdukur, megjithatë kanë mbetur disa. Dokumente të tilla janë burimet arkeologjike si: themelet e kalave, varrezat, tjegullat, armët si dhe emërtimet e ndryshme. Banorët më të vjetër të Llapit ishin dardanët si fis ilir. Vendbanimet e para ishin ngritur pranë lumenjve. Degë ekonomike ishin: gjuetia, blegtoaria etj. Gjatë pushtimit të romakëve kjo hapësirë ka pësuar mjaft dëme sidomos pjesët e fortifikuara. Qendër e rëndësishme e kësaj kohe ishte Vendenisi (Gllamniku).³

Territori i Llapit zë hapësirën veriore dhe është një tërësi mikro-gjeografike. Llapi në kuptimin e gjerë përfshin territorin ujëmbledhës të lumit të Llapit. Ujëmbledhja e Llapit fillon nga Mali i Argjenditë (*Mote Argentorum* ose *Albanikos*, 1789 m), të cilin me vonë serbët e quajtën Kopaonik. Ujëmbledhësi topografik i lumit Llap përfshin sipërfaqen prej 945.4 km. Kjo hapësirë përafërsisht përputhet me territorin administrativ të komunës së Podujevës në ndarjen e tanishme të Kosovës.

Podujeva si qytet në rajonin e Llapit është qendra më e rëndësishme ekonomike, politike, administrative, arsimore, kulturore, shëndetësore etj. Në këtë qendër gravitojnë rreth 120 fshatra edhe pse një pjesë e tyre në aspektin administrativ u përkasin qendrave të tjera të Prishtinës, Vushtrrisë dhe Mitrovicës.

Rajoni i Llapit gjatë historisë ka pësuar ndryshime territoriale dhe administrative. Në periudhën e pushtetit osman ky rajon përfshinte territor të gjerë dhe ishte i organizuar në aspektin administrativ si Nahija e Llapit dhe Nahija e Kosovës me qendër në Kosovë ose Bellasicë (*si quhej ndryshe*). Rajoni i

³ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016 - 2025, fq. 19.

Llapit në aspektin territorial pësoi ndryshime pas Kongresit të Berlinit në vitin 1878, ku më shumë se gjysmën e tokave i pushtoi Serbia, ndërsa popullsia e tyre u shpërngulën me dhunë.

Treva e Llapit është emërtuar nga emri i hidronimit Llap. Ky emërtim filloi të përdorej në Antikë, Mesjetë, duke u ruajtur edhe në Kohën e Re. Këto gjurmë u përkasin disa shtresimeve etno-kulturore dhe gjuhësore:

- 1) (*para*) indoevropiane: **LAB**;
- 2) (*proto*) shqiptare: **LLAP**.

Shumë dijetarë hidronimin Lab e marrin si të lashtë dhe e sjellin nga një alb-, nga mund të dilte lab-, alp-. Forma fonetike të shqipfolësit është Llap. Në mesjetë haset trajta *Lapia*, edhe sot i kanë ruajtur ato emërtime. Forma fonetike të serbët është *Llab*. Ka pasur edhe përpjekje për riemërtim tjetër, por nuk kanë gjetur përkrahje edhe pse nëpër harta gjeografike shpesh janë shënuar. Ngjashëm është edhe me emër-vendin malor GOLLAB, ku germa B është zbutur në P dhe del Gollapi. Kjo e vërteton origjinën ilire që rezulton nga fisë Galabroi-Galabret, të cilët e banonin këtë rajon, i cili u emërtua Gallapi. Kështu dhe Straboni përmend fisin ilir Dardi-Dardet, prej të cilëve edhe u quajtën Dardan dhe emër-vendi, Dardani. Këto mendime janë ngritur mbi baza shkencore. Pushtuesit nuk arritën ta ndryshojnë emërtimin e lumit Llap dhe rajonit të Llapit.⁴

Sot, komuna e Podujevës përbëhet nga qyteti dhe gjithsej 77 fshatra.

POZITA DHE VEÇORITË GJEORAFIKE – Komuna e Podujevës është komuna më e madhe e Republikës së Kosovës, me një sipërfaqe prej 633 km². Shtrihet në pjesën veri-lindore të Kosovës, në luginën e lumit Llap, në një distancë prej rreth 121 km nga Shkupi, 280 km nga Tirana dhe 340 km nga Podgorica. Ajo kufizohet me pesë komuna tjera të Republikës së Kosovës (Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Obiliq, dhe Leposaviq) dhe nga ana veri-lindore kufizohet me Serbinë (*shih shtojcën nr. 3*).

Kjo pozitë e mirë gjeografike dhe rruga ndërkombëtare M25 ka bërë që ndër sektorët më të zhvilluar të Podujevës të jetë tregtia.

⁴ <https://kk.rka-gov.net/podujeve/qyteti/pozita-gjeografike/>

Në territorin e Komunës së Podujevës, relievi është i larmishëm, përbëhet nga male të shumta, me majën më të lartë që është maja e Albanikut me 1,770 metra. Gjithashtu, ajo përmban male si Prugovci, Braina, malet e Turuqicës e Herticës, majet e të cilave nuk e kalojnë 1,100 metra.⁷

Nga ana perëndimore, kufiri paraqet një vijë natyrore kufizuese kundrejt komunës së Mitrovicës, sepse i mbahet shpateve lindore të maleve të Shalës së Bajgores. Nga ana veriore dhe lindore shtrihen malet, të cilat e ndajnë rajonin e Llapit nga Serbia, ku edhe Qafa e Përpellacit, Qafa e Merdarit dhe Qafa e Tullarit, ndërsa nga ana e jugut luginës së Llapit del në Fushën e Kosovës, e cila fillon nga fshati Besi-Barilevë. Territori i Llapit është vend malor, por e ka edhe fushëgropën e Llapit si tokë pjellore.

Fig. 3 Pozita gjeografike e komunës së Podujevës



Llapi si tërësi mikro-gjeografike ndahet në tri pjesë:

1. **Fushëgropa e Llapit**, e cila shtrihet prej fshatit Repë në veri dhe në jug deri te fshati Besi - Barilevë, me një gjatësi prej më se 35 km dhe me një gjerësi prej 12-15 km në vijën Batllavë - Llapashticë e Epërme;
2. **Gryka e Llapit**, e cila përfshin territorin prej fshatit Repë deri në fshatin Murgull, me një gjatësi prej rreth 14 km, dhe nga Bellasica deri te Kepi i Uglarit, që është rreth 14 km në gjerësi;
3. **Gallapi i Llapit**, i cili shtrihet nga fshati Batllavë e deri në fshatin Medergoç dhe nga fshati Turuqicë deri në Keqekollë dhe Koliq. Rajoni i Llapit ka lartësinë mesatare prej 826 m. në vetëm 4.8 km të sipërfaqes së Llapit. Ky territor ka më shumë vise kodrinore-malore.

Podujeva me rrethinë shtrihet në shkallën prej 42-41-35 deri 43-08-13 të gjatësisë gjeografike veriore dhe 20-58-35 deri 21-26-35 të gjatësisë gjeografike lindore.

Rrethi i Llapit përbëhet nga tri tërësi. Relievi malor i jep karakteristikën e hapësirës gjeografike. Kategorisë së territorit kodrinor dhe malor i përkasin 3/4 e sipërfaqes dhe për këtë cilësohet rajon me

⁷ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2020-2022, fq. 15.

pak fushor. Nga tri anët shtrihen malet dhe vetëm në derdhjen e lumit Llap lidhet me Fushën e Kosovës. Rajoni i Llapit ka lartësinë mesatare prej 826 m dhe për 4 m është me i ulët se rajoni i Kosovës. Pamja e përgjithshme ndryshon për shkak të përbërjes morfologjike dhe gjeologjike.

Në anën veriore dhe në anën perëndimore ngritën malet që i përkasin sistemit të maleve të Argjendta (Kopaunikut). Pjesa e maleve më të larta të këtij sistemi shtrihen më në perëndim, në kufi me Shalën e Bajgores, respektivisht me komunën e Mitrovicës dhe Vushtrrisë si: Maja e Mprehtë e Ostrokopja (1,879 m), Bareli (1,583 m), Mali i Ukshin Kovaqices (1,379 m), Kepi i Sokolit, Mali i Musë Popovës, Gerdec (838 m), Hunda e Lugut (763 m). Në pjesën lindore të Llapit shtrihen: Mali i Uglarit ose Kepi i Uglarit (1,297 m), Kertinjaku (1,147 m), Perpellaci (947 m), Mali i Kravarices (963 m), Malet e Batllavës (1,213 m), Mali i Merkonjes (1,017 m), Mali i Brainës (933 m), Gallapi, Suka e Shakovicës (671 m) dhe Mali i Rumanishtes.

Tërësinë morfologjike të rajonit të Llapit e përbën kryesisht fusha aluviale e lumit Llap dhe degëve të tij: lumit të Dumnicës, lumit të Batllavës, lumit të Kacanollit si dhe lumenj dhe përrenj të tjera më të vegjël. Para fazës liqenore bëhet shfaqja intenisive vullkanike. Nga kjo kohë kanë mbetur tarra fluviale anësore të brigjeve të lumit Llap dhe me këtë u bë ngushtimi i shtratit të lumit. Llapi në pjesën e tij me veriore shtron zalle të trashë dhe në rrjedhën e mesme dhe të poshtme rërë dhe lym. Me këtë toka bëhet pjellore dhe e përshtatshme për bujqësi dhe kopshtari.⁷

Në territorin e Podujevës gjenden dy depozitat minerale ndër më të mëdhatë në Kosovë. Miniera Çuka e Batllavës dhe Depozita e Bellasicës, të pasura me plumb, zink, argjend dhe minerale si silicified, antigoritë, sfaleritë, piritë-limonitë, klorin, galenitë, kuarc, feldspat, karbonet, zirkon, turmalinë, muskovitë etj. Gjithashtu, një burim tjetër natyror i rëndësishëm për Komunën e Podujevës është edhe Banja e Sallabajës, burim natyror i ujit termo-mineral i cili është provuar se kuron shumë sëmundje. Temperatura e burimit në këtë banjë është rreth 23 °C.⁸

Klima: Komuna e Podujevës ka klimë të mesme kontinentale. Në klimë ndikojnë faktorë mikroklimatik që japin disa specifika të vogla kësaj hapësire. Prej faktorëve mikroklimatik më të rëndësishmit janë

⁷ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2020-2022, fq. 15.

⁸ <https://kk.rks-gov.net/podujeve/qyteti/pozita-gjeografike/>

⁹ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2020-2022, fq. 15.

fushëgropa e Llapit dhe malet që e rrethojnë nga të gjitha anët. Efekti i maleve është se kanë reshje më shumë, temperatura më të ulëta, bora qëndron më gjatë, janë të mbuluara me pyje etj.

Pra, temperaturat në këtë komunë oscillojnë dhe kanë mjaft dallime mujore dhe sezonale. Temperatura mesatare është 9.6 °C, muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare -2.1 °C, muaji më i ngrohtë është korriku dhe gushti me 20.1 °C. Muaji më i ftohtë me temperaturë ekstreme është janari me -27.2 °C, ndërsa muaji me temperaturë më të lartë është gushti me 37.0 °C. Amplituda më ekstreme për këtë periudhë është 64.2 °C. Në periudhën vegetative paraqiten temperatura negative që nganjëherë sjellin dëme në bujqësi.

Sasia vjetore e reshjeve është 697 mm që është nën mesataren e Kosovës për këtë periudhë (784mm). Muaji më i lagësht është maji (77.5) ndërsa muaji më i thatë marsi me 42.3 mm. Mesatarisht me bore janë 26 ditë, ndërsa me mbulesë bore janë 48.4 ditë, ose një muaj e gjysmë. Pjesa më e madhe vitit është pa mbulesë bore. Muaji që ka ditë me mbulesë bore më së shumti është shkurti me 11.7 ditë.

Me së shumti fryjnë erërat veriore, jugore dhe më pak verilindore. Shpejtësi me të madhe mesatare kanë erërat veriore dhe jugperëndimore. Për të gjitha erërat e drejtimet që i kanë shpejtësi mesatare 3-4 m/s, nuk kanë dallime ndërmjet tyre. Shpejtësia maksimale është te erërat jugore deri 18.9 m/s.⁹

Kurse, sa i përket hidrologjisë, komuna e Podujevës posedon ujë në formë të lumenjve, si dhe liqeneve. Disa nga lumenjtë e Komunës së Podujevës janë: lumi i Dumnicës, Lumi Batllava, Lumi i Kaqandolit, Vrella e Revuçit, dhe Lumi i Llapit i cili është lumi me më së shumti prurje të ujit. Rezervati më i madh në komunën e Podujevës është Liqeni Artificial i Batllavës. Nga ky liqen furnizohen me ujë banorët nga Podujeva, gjysma e Prishtinës, Lipjani e vende të tjera përreth. Ujësijellësi nga liqeni fabrikon 34 milion kub ujë brenda një viti.¹⁰

⁹ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 82-83.


¹⁰ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2020-2022, fq. 15.

POPULLSIA - Komuna e Podujevë ka gjithsej **88,499 banorë**, bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011. Rezultatet e regjistrimeve të popullsisë në këtë komunë për periudhën 1948-2011 janë paraqitur në grafikun nr. 1.

Siç shihet në grafikun në vijim, që nga viti 1948 e deri në vitin 1991, komuna e Podujevës ka pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë. Nëse krahasojmë regjistrimin në vitin 1948 dhe 2011, shihet që popullsia është dyfishuar në vitin 2011. Mirëpo, regjistrimi i vitit 2011 kundrejt atij të parafundit në vitin 1991, ka rënie prej 4.78%.



Graf. 1 Popullsia në komunën e Podujevës sipas regjistrimeve, periudha 1948-2011



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Popullsia sipas vendbanimeve në komunën e Podujevës, 1948-2011.*

Dendësia: Në komunën e Podujevës dendësia e popullsisë është rreth 140 banorë në 1 km², bazuar në popullsinë totale të regjistruar në vitin 2011 (88,499 banorë) dhe sipërfaqen e territorit të saj (633 km²).

Dendësia e popullsisë është pak nën mesataren në nivel vendi prej 160 banorë në 1 km². Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.


Dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Podujevës ku mesatarisht jetojnë rreth 2,635 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Letanc (660 b/km²), Obrançë (529 b/km²), Surkish (500 b/km²), Llugë (444 b/km²), Gllamnik (405 b/km²) etj. Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Rakinice (3 b/km²),

Murgulle, Bllatë dhe Tërnavicë (4 b/km²), Metergoc (5 b/km²) etj, derisa Muhazobi, Përpellaci, Radujevci dhe Reçica nuk janë të populluara.¹¹

Shtimi natyror: Nëse e analizojmë rritjen e popullsisë prej vitit 1948 e deri në vitin 2011, komuna e Podujevës e ka dyfishuar atë. Ndërsa, regjistrimi i vitit 2011 qet në pah një rënie prej 4.78% të popullsisë krahasuar me regjistrimin e vitit 1991. Statistikat e tri viteve të fundit (2019-2021) nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, tregojnë se kemi një rritje prej rreth 26% të shtimit natyror në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Ndërsa, në vitin 2020 kemi një rritje prej 6.5% të shtimit natyror, krahasuar me vitin 2019.

Edhe nataliteti ka rritje mesatare prej 15.6% për periudhën 2019-2021. Mortaliteti ka rritje në vitin 2020 kundrejt vitit 2019 (30.4%). Ndërsa në vitin 2021 vërehet një rritje e vogël prej 2.2% kundrejt vitit 2020. Më gjerësisht, shih figurën në vijim.

Graf. 2 Shtimi natyror në komunën e Podujevës, periudha 2019-2021



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror në nivel të komunave, 2017-2021.*

¹¹ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 27.

Struktura gjinore: Sa i përket strukturës gjinore në këtë komunë, ka pak diferencë. Sipas regjistrimit të vitit 2011, 50.80% (44,955) janë meshkuj, ndërsa 49.20% (43,544) janë femra.


Graf. 3 Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Podujevës



Burimi: ASKDATA: Popullsia e komunës së Podujevës sipas gjinisë 2011.

Struktura etnike: Struktura etnike e popullsisë në komunën e Podujevës është shumë homogjene, meqë 98.90% e popullsisë janë shqiptarë. Pastaj vijmë: ashkalinj 0.77%, rom 0.08%, serbë 0.01%, dhe të tjerë 0.24%. Më gjerësisht shih figurën në vijim, ku janë paraqitur grafikisht të gjitha etnicitetet me përqindje në pjesëmarrjen totale prej 100%.

Graf. 4 Struktura etnike e popullsisë në komunën e Podujevës



Burimi: ASKDATA: Popullsia e komunës së Podujevës sipas etnicitetit 2011.

Struktura religjioze: Edhe struktura religjioze e popullsisë në komunën e Podujevës është mjaft homogjene meqë: 99.73% e popullsisë i takojnë besimit islam, pastaj besimit katolik 0.02% dhe besimit

ortodoks 0.01%. Prej gjithsej të regjistruarve, 0.24% nuk janë deklaruar apo u takojnë besimeve tjera. Më gjerësisht shih figurën në vijim, ku janë paraqitur grafikisht religjionet përkatës me përqindje në pjesëmarrjen totale prej 100%.


Graf. 5 Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Podujevës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Podujevës sipas religjionit 2011.*

Struktura moshore: Siç shihet në grafikun në vijim, komuna e Podujevës ka strukturë moshore relativisht të re. Rreth 49.5% e popullsisë janë nën moshën 24 vjeçare. Ndërsa vetëm 5.8% i takojnë grupmoshave jo aktive për punë, prej 65 e tutje. Më gjerësisht, për secilën grupmoshë, shih figurën në vijim ku janë paraqitur edhe me përqindje.

Graf. 6 Struktura moshore e popullsisë në komunën e Podujevës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Podujevës sipas grupmoshës 2011.*


VENDBANIMET - Komuna e Podujevës ka gjithsej **78 vendbanime**. Njëzetepesë vendbanime të komunës së Podujevës kanë më shumë se 1,000 banorë. Qyteti i Podujevës si vendbanim ka numrin më të madh të popullsisë (23,453), krahasuar me vendbanimet tjera. Megjithatë, duhet theksuar se mbizotëron shtrirja e popullsisë në zona rurale (73.5%), ndërsa, në zonë urbane jetojnë 26.5% e tyre.

Dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Podujevës ku mesatarisht jetojnë rreth 2,635 banorë në një km². Gjithashtu ekzistojnë edhe disa vendbanime të tjera të cilat kanë dendësi të madhe siç janë: Letanc (660 b/km²), Obrançë (529 b/km²), Surkish (500 b/km²), Llugë (444 b/km²), Gllamnik (405 b/km²) etj. Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Rakinice (3 b/km²),

Murgulle, Bllatë dhe Tërnavicë (4 b/km²), Metergoc (5 b/km²) etj, derisa Muhazobi, Përpellaci, Radujevci dhe Reçica nuk janë të populluara.¹²

Numri i ekonomive familjare sillet prej 0 deri në 3,792 (qyteti i Podujevës). Gjithsej janë të regjistruara 13,440 ekonomi familjare. Më gjerësisht, shih tabelën në vijim.

Fig. 4 Pamje e qytetit të Podujevës



¹² Plan i zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 27.

Tab. 1 Popullsia e komunës së Podujevës sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare

Nr.	VENDBANIMI	POPULLSIA	EKONOMITË FAMILJARE	Nr.	VENDBANIMI	POPULLSIA	EKONOMITË FAMILJARE
1	Bajcinë	2,338	342	40	Mendar	188	29
2	Balloçë	2,131	362	41	Metshi	1,251	183
3	Baraninë	98	15	42	Metargoc	79	12
4	Batllavë	2,334	346	43	Miroc	132	24
5	Bellapojë	1,412	207	44	Muharob	-	-
6	Bërvenik	72	11	45	Murgull	135	17
7	Bllatë	9	1	46	Obrancë	3,092	489
8	Bradash	2,567	394	47	Ovllan	844	138
9	Brasinë	268	42	48	Pakashticë e Epërme	732	102
10	Brecë	119	16	49	Pakashticë e Poshtme	292	41
11	Buricë	240	40	50	Penahë	539	79
12	Dobërdol	1,106	173	51	Peran	1,241	182
13	Dobratin	1,574	218	52	Përpellac	-	-
14	Dumnice e Epërme	497	60	53	Podajevë	23,453	3,792
15	Dumnice e Poshtme	2,975	442	54	Pollatë	239	29
16	Dumosh	1,207	176	55	Popovë	181	21
17	Dvorahitë	143	19	56	Potok	61	8
18	Dyz	573	80	57	Radujevi	-	-
19	Gërdoc	1,263	187	58	Rakinicë	14	1
20	Gllamnik	3,794	556	59	Reçicë	-	-
21	Godishnjak	353	53	60	Repi	484	68
22	Halabak	623	88	61	Revog	924	129
23	Hërticë	741	96	62	Sallabajtë	506	75
24	Kacybeg	494	69	63	Sheçel	1,739	261
25	Kalaticë	89	15	64	Siboc i Epërme	961	155
26	Kërpisosh	735	116	65	Siboc i Poshtëm	454	67
27	Kumshoc	873	125	66	Sllatinë	130	16
28	Kushovicë	204	38	67	Surdull	27	4
29	Litanc	2,080	299	68	Surkish	1,291	169
30	Livadice	296	40	69	Sylevcë	63	8
31	Lupq i Epërme	273	38	70	Sheqkoc	1,304	235
32	Lupq i Poshtëm	2,113	322	71	Shakevicë	619	93
33	Lladoc	821	121	72	Sheshim	1,148	180
34	Llapshiticë e Epërme	2,363	321	73	Tërnavë	853	125
35	Llapshiticë e Poshtme	2,701	389	74	Tërnavicë	27	4
36	Llauhë	980	128	75	Turajicë	109	15
37	Llogë	1,404	230	76	Vëlçarskë	344	80
38	Lluzhan	757	113	77	Zakut	453	63
39	Majac	1,622	239	78	Zhiti	98	12

Gjithsej 98,199 banorë dhe 13,440 ekonomi familjare

Burimi: ASKDATA: Popullsia e komunës së Podujevës sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare 2011.

Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Podujevës mund të kategorizohen si në figurën në vijim. Prej 78 vendbanimeve, 4 (5.13%) nuk janë të populluara fare, 32 (41.03%) janë vendbanime rurale deri në 500 banorë, 17 (21.80%) janë vendbanime rurale prej 500-999 banorë, 13 (16.66%) janë vendbanime rurale prej 1,000-1,999 banorë, 11 (14.10%) janë vendbanime prej 2,000-4,999 banorë, dhe mbi 5,000 banorë vetëm qyteti i Podujevës (1.28%). Më gjerësisht, shih shtojcën nr. 3.

Graf. 7 Kategorizimi i vendbanimeve në komunën e Podujevës



Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Podujevës mund të kategorizohen si në vijim.


Tab. 2 Klasifikimi i vendbanimeve në komunën e Podujevës

Deri në 500 banorë		500-999 banorë	1,000-1,999 banorë	2,000-4,999 banorë	Mbi 5,000 banorë
Bllatë Rakinice Surdull Temavice Potok Sylevice Bërvenik Metergoc Kalaticë Barainë Zhst Turupice Breçë Slatinë Miroc Murgull Dvanshtë Popovë	Mendar Kushevica Pollatë Buricë Brainë Lupq Epërm Pakashitice e Posttme Livadicë Godishnjak Zakut Siboc Poshtëm Repë Kacybeg Dumnicë e Epërme	Sallabajë Penuhë Velikarekë Dyz Shakovicë Halabak Pakaashitice e Epërme Hërticë Kerpimëh Llužhan Liadoc Orlian Tërnave Kurushëc Revuq Siboc i Epërm Llaushtë	Sukish Dobërdol Shtedim Dumosh Penac Metehi Gerdac Liugë Bellopojë Shajkoc Dobratin Majac Shtëçel	Letanc Lupq i Poshtëm Bafioçë Bafllavë Bajcinë Llapashitice Epërme Brodash Llapashitice e Poshtme Dumnicë e Poshtme Obrancë Gllamnik	Qyteti i Podujevës

Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Podujevës sipas vendbanimit, 2011.*

Në vijim është paraqitur grafiksht, numri i popullsisë sipas vendbanimeve, bazuar në regjistrimet 1948-2011.

Graf. 8 Regjistrimi i popullsisë sipas vendbanimeve, 1948-2011



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Podujevës sipas vendbanimit, 1948-2011.*

Nga gjithsej (78) vendbanimet e komunës së Podujevës, 48 prej tyre kanë rritje të popullsisë prej vitit 1948 në atë 2011. Rritja më e ultë është 5% (Merdar) dhe më e larta 863% (qyteti i Podujevës). Disa nga vendbanimet tjera që kanë shënuar rritje të dukshme janë: Llapashticë e Poshtme, Shtedim, Surkish, Letanc, Obrançë, Lluzhan, Siboc i Epërm etj.

Ndërsa, vendbanimet që kanë pësuar rënie janë 30. Disa tashmë janë të pabanuara fare, pastaj vijnë vendbanimet të cilat kanë pësuar rënie të dukshme: Bllatë, Rakinicë, Metergoc, Tërnavicë, Bërvenikë, Turuçicë, Brainë, Murgull, Sylevicë, Surdull, Popovë, Brecë etj.

MIGRIMI - është lëvizja e njerëzve nga një vend në tjetrin me qëllime të ndryshme si vendosja e përkohshme ose e përhershme. Migrimi ndikon në kulturën, stilin e jetës dhe qëndrimin politik të një kombi.

Të dhënat dhe statistikave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se në komunën e Podujevës, migrimi kombëtar në vitin 2020 kishte shënuar një rënie (32.3%) krahasuar me vitin 2019, megjithatë viti 2021 ka shënuar rritje (19.0%) kundrejt vitit 2020.

Ndërsa, migrimi ndërkombëtar në vitin 2020 ka shënuar rënie të madhe. Mirëpo, në vitin 2021 ka rritje drastike krahasuar me vitin 2020. Më konkretisht, shih tabelat në vijim.

Tab. 3a Migrimi kombëtar në komunën e Podujevës, periudha 2019-2021

Migrimi kombëtar	2019	2020	2021
Imigrimi	163	110	131
Emigrimi	823	557	663
Bilanci i migrimit kombëtar	-660	-447	-532

Tab. 3b Migrimi ndërkombëtar në komunën e Podujevës, periudha 2019-2021

Migrimi ndërkombëtar	2019	2020	2021
Imigrimi	412	587	231
Emigrimi	1,774	423	2,195
Bilanci i migrimit ndërkombëtar	-1,362	164	-1,964

Burimi: ASKDATA: *Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi, 2019 - 2021.*

ARSIMI - është shumë i rëndësishëm në çdo shoqëri. Është burim rritjeje dhe zhvillimi për të formësuar jetën e individëve të tjerë dhe për të arritur një shoqëri më të mirë.

Rëndësia e arsimit në shoqërinë moderne është e madhe. Brezi i tanishëm ka nevojë për arsim për të arritur mundësi më të mira punësimi dhe për t'u bërë në qytetarë më të mirë.

Shoqëria moderne ka probleme moderne, andaj duke zhvilluar aftësitë e zgjidhjes së problemeve, arsimimi ndikon në zgjidhjen e shumë çështjeve njerëzore. Kuptimi dhe rëndësia e arsimit në shoqëri

bëhet e qartë vetëm kur shohim rritje ekonomike. Akademikët dhe punonjësit e arsimuar punojnë drejt arritjes së qëllimeve ekonomike. Arritjet e tyre transformojnë edhe jetën e njerëzve që i përkasin komuniteteve të marginalizuara. Rrjedhimisht, prosperiteti ekonomik i një vendi varet shumë nga popullsia e arsimuar që ata kanë.

Sistemi arsimor në Kosovë: Arsimi në Kosovë zhvillohet në institucione shoqërore dhe private. Duke filluar nga viti 1999, arsimi në Kosovë iu nënshtrua reformave të thella në të gjitha nivelet. Këto reforma kishin për synim përshtatjen e arsimit në Kosovë sipas standardeve bashkëkohore evropiane e botërore.

Arsimi është themeli i një shoqërie të shëndoshë i cili garanton perspektivë për të ardhmen shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike të një vendi. Pas vitit 2000 institucionet kosovare bënë përpjekje në realizimin e programeve mësimore bashkëkohore.¹³

Sot, sistemi arsimor në Kosovë është duke funksionuar sipas modelit 5+4+3 nga viti 2002. Sipas këtij modeli: 5 vite janë në arsimin fillor, pastaj vazhdohet me 4 vite të shkollimit të mesëm të ulët dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të mesëm të lartë.

Edhe struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Podujevës është e organizuar në tri nivele: arsimin fillor (klasat I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasat VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat X – XII).

Në komunën e Podujevës arsimi është i organizuar në 60 institucione shkollore. Prej tyre 1 çerdhe, 55 shkolla të nivelit fillor dhe mesëm të ulët dhe 4 shkolla të nivelit mesëm të lartë (*shih shtojcën nr. 4*).

Arsimi parashkollor dhe parafillor: Sipas të dhënave dhe statistikave nga ASK, në komunën e Podujevës ka një çerdhe për fëmijët e moshës nën 5 vjet. Mirëpo, në shumicën e shkollave fillore në vend ofrohet arsimim njëvjeçar parashkollor për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeçare.

Burimi i njëjtë qet në pah një numër të vogël që kanë vijuar arsimin parashkollor. Në vitin 2019/2020, 61 fëmijë. Ndërsa, në vitin vijues (2020/2021), kanë vijuar mësimin 53 fëmijë. Vërehet një rënie prej 13.1% në vitin e fundit.



¹³ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 33.

Numri mesatar i mësimdhënësve për periudhën 2019-2021 për nivelin parafillor është 8. Rrjedhimisht raporti mesatar nxënës/mësimdhënës për këtë periudhë është 7.13 (i favorshëm kundrejt mesatares 9.3 në nivel vendi).

Arsimin parafillor në vitin 2019/2020, e kanë ndjekur 1,129 nxënës. Në vitin 2020/2021, këtë nivel e kanë ndjekur 1,044 nxënës. Vërehet një rënie prej 7.5% në vitin e fundit.

Arsimi i mesëm i ultë: Bazuar në statistikat e ASK-së për komunën e Podujevës, këtë nivel arsimit në vitin shkollor 2019/2020 e kanë ndjekur 12,289 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2020/2021, 11,913 nxënës. Siç shihet ka pasur një rënie prej 3.06% nga viti në vit.

Në vitin shkollor 2020/2021 raporti nxënës për paralele në komunën e Podujevës ishte 19.15, kundrejt 18.12 në nivel vendi.


Numri mesatar i mësimdhënësve për periudhën 2019-2021 për nivelin parafillor dhe të mesëm të ultë është 916. Rrjedhimisht raporti mesatar nxënës/mësimdhënës për këtë periudhë është 14.40 (i favorshëm kundrejt mesatares 16.6 në nivel vendi).

Arsimi i mesëm i lartë: Këtë nivel arsimit në vitin 2019/2020 e kanë ndjekur 4,121 nxënës. Në vitin 2020/2021, 3,863 nxënës. Ka një më rënie prej 6.26% nga viti në vit.

Në vitin shkollor 2020/2021 raporti nxënës për paralele në komunën e Podujevës ishte 25.25, kundrejt 22.32 në nivel vendi.

Numri mesatar i mësimdhënësve për periudhën 2019-2021 për nivelin e mesëm të lartë është 239. Rrjedhimisht raporti mesatar nxënës/mësimdhënës për këtë periudhë është 16.70 (i lartë kundrejt mesatares 13.9 në nivel vendi).

Graf. 9 Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare në komunën e Podujevës, 2015-2021¹⁴



Burimi: ASKDATA: Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2015-2021.

Siç shihet në grafikun e mësipërm, ka rënie të nxënësve nga viti në vit për periudhën e analizuar.

Bazuar në të dhënat nga ASK (periudha 2018-2021), raporti mesatar nxënës/mësimdhënës sipas niveleve në arsimin publik është:

- Arsimi parashkollor: 9.3;
- Arsimi parafilior: 19.2;
- Arsimi i mesëm i ultë: 14.0;
- Arsimi i mesëm i lartë: 13.9.

Hulumtimi i vitit 2011 nga ASK mbi popullsinë e moshës 10 vjeçe e mbi, sipas nivelit të arsimimit dhe njohjes së shkrim-leximit, qet në pah se pjesa më e madhe e popullsisë së komunës së Podujevës kanë të përfunduar shkollimin e mesëm të ultë (34.13%), pastaj të mesëm të lartë (30.45%) dhe atë fillor

(18.63%). Prej tyre të diplomuar rezultuan 5.22%, ndërsa me studime postdiplomike vetëm 0.29%. Prej gjithsej të anketuarve, 11.28% e tyre nuk kanë përfunduar asnjë lloj niveli të arsimit.

Gjatë vitit 2021, komuna e Podujevës ka shpërndarë nëpër shkolla 112 tituj me 30 mijë ekzemplarë të lektyrave shkollore në vlerë 49,865.76€. Ndërsa, bursa për nxënës e studentë, në vlerë 52,800€.¹⁵

Nuk duhet lënë anash faktin se Marrëveshja e Stabilizim - Asocimit (MSA) përcakton kornizën e bashkëpunimit të Kosovës me Bashkimin Evropian (BE) për ngritjen e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, me qëllim të përmirësimit të shkathhtësive, punësueshmërisë, përfshirjes sociale dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik. MSA i kushton kujdes të veçantë bashkëpunimit për arritjen e gjithëpërfshirjes dhe barazisë në arsim, me theks të veçantë, gjininë, përkatësinë etnike dhe fetare, si dhe personat me aftësi të veçanta. Pritet që bashkëpunimi në mes të BE-së dhe Kosovës të merr formën e asistencës teknike për jetësimin e masave të caktuara të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK-ut).¹⁶

SHËNDETËSIA - Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të listës prioritare të projekteve ka inkorporuar edhe projektin për fuqizimin e infrastrukturës në kujdes parësor. Veprimtaria e kujdesit parësor shëndetësor përfshin promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë kujdesin dentar dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike mbështetur në konceptin e mjekësisë familjare.¹⁷

Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është përgjegjësi e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - QKMF, në kuadër të së cilës funksionojnë 4 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 18 Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF), të shpërndara në 22 vendbanime të komunës, me një dendësi prej 1 objekti shëndetësor në çdo 29 km².¹⁸



¹⁵ Raporti gjashtëmuor 2021 i komunës së Podujevës, fq. 4.

¹⁶ Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023, fq. 11.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Plan i zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 41.

Rrjedhimisht, kujdesi primar shëndetësor në komunën e Podujevës është i organizuar në 23 objekte shëndetësore si në vijim (*shih shtojcën nr. 5*):

- 1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Podujevë.
- 4 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në: Kërprimëh, Lluzhan, Orlan dhe Podujevë.
- 18 Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF) në: Bajçinë, Batllavë, Bradash, Dobratin, Dumnicë, Dyz, Gllamnik, Halabak, Herticë, Llapashticë, Lupç etj.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), si bartëse e kujdesit primar, është e vendosur në qytetin e Podujevës dhe ofron shërbime në tri objekte me hapësirë më se 2000 m². Ky objekt është rindërtuar në vitet e '80ta me destinim shëndetësor që nga fillimi si objekt dhe sot gjendja fizike e tij është e kënaqshme.¹⁹

Numri i të punësuarit në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas profesioneve në komunën e Podujevës në vitin 2019 dhe 2020 ishte i njëjtë, 241. Prej tyre, 58 mjekë, 4 stomatologë, 127 infermierë dhe 52 punëtorë shëndetësorë.²⁰

Në sistemin shëndetësor primar bën pjesë edhe sektori privat. Sektori privat i shëndetësisë primare në komunën e Podujevës ka shënuar zhvillim të theksuar viteve të fundit. Sot në sektorin privat veprojnë më se 43 institucione shëndetësore-ordinanca private të cilat aktivitetin e tyre e zhvillojnë kryesisht në zonën urbane. Në këto ordinanca ofrohen shërbime: pediatrike, internistike, gjinekologjike, stomatologjike dhe mjekësisë familjare, ku punojnë specialist të degëve përkatëse të cilët kanë një rol me rëndësi dhe në një mënyrë kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për banorët e komunës.²¹

Grafiku në vijim tregon numrin e vizitave të përgjithshme në QMF në komunën e Podujevës në vitin 2019 dhe 2020.

¹⁹ Plan i zhvillimor i komunës së Podujevës 2016–2025, fq. 42.

²⁰ ASKDATA: Të punësuarit në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas profesioneve, 2016-2020.

²¹ Plan i zhvillimor i komunës së Podujevës 2016–2025, fq. 46.

Po ashtu, nëse e analizojmë numrin e përgjithshëm të vizitave mjekësore në QMF me numrin e përgjithshëm të popullsisë në këtë komunë, rezulton se mesatarja e vizitave mjekësore vjetore për person në vitin 2019 ishte rreth 10 herë, ndërsa në vitin 2020 rreth 9 herë.

Po ashtu, vërehet një rënie e përgjithshme e vizitave në QMF prej 13.9%. Më gjerësisht sipas kategorive, shih informatat e prezantuara në grafikun në vijim.

Graf. 10 Krahasim i numrit të vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas kategorive, 2019-2020



Burimi: ASKDATA: Numri i vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare, 2019-2020.

Gjatë vitit 2021, komuna e Podujevës ka funksionalizuar ultrazërin në vlerë 24,000€, në repartin e maternitetit. Po, ashtu ka funksionalizuar dhe kompletuar sallën e infuzioneve në emergjencë, laboratorin viro-bakteriologjik, mamografin, repartin e stomatologjisë etj. Si dhe ka subvencionuar me barna 254 familje, në vlerë totale prej 27,600€.²²

Statistikat e ASK për periudhën 2016-2020 tregojnë se mesatarja vjetore e të sëmurëve me sëmundje malinje në këtë komunë është 130. Vërehet një rënie mesatare prej 7.8% përgjatë viteve të analizuara.

Në vijim janë ranguar shkaqet kryesore të vdekjes në komunën e Podujevës, bazuar në statistikën e ASK për vitin 2018 dhe 2019.

²² Raporti gjaahëmujor 2021 i komunës së Podujevës, fq 5.

Tab. 4 Rangimi i grupeve kryesore të shkaqeve të vdekjes në komunën e Podujevës, 2018-2019

Nr.	GRUPET KRYESORE TË SHKAQEVE TË VDEKJES	2018 (%)	2019 (%)
1	Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	38.8	44.4
2	Simptomat, shenjat dhe rezultatet jonormale klinike dhe laboratorike të paklasifikuara gjetiu	5.3	15.8
3	Sëmundjet e sistemit urogjenital	4.9	9.7
4	Tumoret	4.5	8.2
5	Shkaktarët e jashtëm të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë	2.4	6.1
6	Sëmundjet endokrine, të ushqyeshmerisë dhe metabolike	2.4	1.5
7	Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	34.8	2.0
8	Sëmundjet infektive dhe parazitare	1.2	4.6
9	Sëmundjet e sistemit nervor	0.4	0.0
10	Sëmundjet tjera	5.3	7.7
Gjithsej		100	100

Burimi: ASKDATA: Rangimi i 10 grupeve të shkaqeve të vdekjes sipas vendqëndrimit (komunës) në Kosovë, 2018-2019.

Siç shihet nga tabela e mësipërme, dominojnë sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut.

MIRËQENIA SOCIALE – përfshin kujdesin shëndetësor, fuqizimin, strehimin dhe programe të tjera të orientuara drejt ndihmës së të varfërve, të papunëve dhe të marginalizuara në shoqëri. Me fjalë të tjera, sistemi i mirëqenies sociale është një rrjet programesh i krijuar për të ndihmuar banorët e një vendi në faza të ndryshme të jetës së tyre.

Në Komunën e Podujevës, shërbimet sociale ofrohen nëpërmjet Qendrës për Punë Sociale (QPS). Çështja e banimit ka qenë njëra ndër fushat kryesore të adresimit social të komunës gjatë viteve të fundit. Mbështetja financiare e familjeve skamnore kryesisht është bërë për blerjen e barnave apo nevojave tjera shëndetësore. Komuna nëpërmjet subvencioneve ka përkrahë OJQ të ndryshme, sidomos ato të personave me aftësi të kufizuara.²³

Të dhënat e fundit nga ASK për vitin 2020 (TM1-TM4) tregojnë se në komunën e Podujevës janë mesatarisht 4,464 persona apo 956 familje të cilat kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale. Ndërsa për vitin 2021 (TM1-TM4), janë mesatarisht 4,448 persona apo 966 familje.

²³ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016–2025, fq. 51.

Faktorët kryesorë që e shkaktojnë këtë përqindje të lartë të varfërisë, sidomos në disa nga vendbanimet e komunës së Podujevës janë: largësia e theksuar nga zona urbane (qendra), relievi, shkalla e ulët e arsimimit, kushtet jo të mira të banimit.²⁴

Gjatë vitit 2021, komuna e Podujevës ka dhuruar katër (4) shtëpi për familjet në nevojë.²⁵

TREGU I PUNËS – Në vijim janë përmbledhur disa statistika të përgjithshme mbi tregun e punës në Kosovë.

Graf. 11 Statistikat e tregut të punës, 2020, në Republikën e Kosovës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021*, fq. 18-19.

Siç shihet në grafikun e mësipërm, fuqia ekonomike aktive për vitin 2020 ishte 468,451 persona. Rrjedhimisht, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë ekonomike aktive për vitin 2020 rezultoi 30.5% (rreth 10% më e ulët se në vitin 2019). Ndërsa, fuqia ekonomike aktive për vitin 2020 ishte 753,654 persona që rezultoi në 61.7% shkallë të pjesëmarrjes në fuqinë ekonomike aktive për vitin 2020.

²⁴ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2020-2022, fq. 40.

²⁵ Raporti gjashtëmuor 2021 i komunës së Podujevës, fq 5.

Po ashtu, të dhënat nga ASK, tregojnë se në vitin 2020 ishin të punësuar 347,071 persona, që rezultoi në 28.4% shkallë të punësimit. Po në të njëjtin vit të papunë ishin 121,379 persona, pra shkalla e papunësisë sillej rreth 25.9%.

Numri i personave kontributdhënës në Trustin pensional nga komuna e Podujevës ishte: 17,760 (viti 2019) dhe 15,877 (viti 2018). Pra, në vitin 2019 rreth 11.86% më shumë se në vitin paraprak.²⁰ Ndërsa, në vitin 2020, 18,336 kontributdhënës ose 3.2% më shumë se në vitin 2021.

²⁰ <https://www.komunat.institutigap.org/Statistics/index/Podujev%C3%AB-18-18-18/273-196-271/y-y-y>

SHËRBIMET ADMINISTRATIVE - Komuna e Podujevës ka gjithsej 11 drejtori të cilat janë prezantuar detajisht te skema organizative e komunës (shih shtojcën nr. 2). Sipas statistikave të institutit GAP, në vitin 2019 ishin të punësuar 261 persona si shërbyes civilë.

Komuna është përgjegjëse kryesisht për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve primare ndaj qytetarëve, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale - Ligji Nr. 03/L-040. Si rezultat, komuna e Podujevës i ofron të gjitha shërbimet dhe merr përgjegjësitë e përcaktuara nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

Komuna e Podujevës në aspektin e organizimit administrativ dhe territorial ndahet në 19 qendra lokale, ndërsa vet qyteti i Podujevës ndahet në tri bashkësi lokale si në vijim.

Tab. 5 Organizimi administrativ në komunën e Podujevës

Nr.	Ndarja administrative e komunës së Podujevës	
1	Podujevë	Podujevë, (Lagjja I), Letanci
2	Podujevë	Podujevë (Lagjja II), Perani, Obranca
3	Podujevë	Podujevë (Lagjja III)
4	Dumnicë e Poshtme	Dumnicë e Poshtme, Dumnicë e Epërme, Llaushë, Përpeçac
5	Shtedim	Shtedim, Miroc, Merdar, Livadhi (Livadicë)
6	Sveçël	Sveçël, Shajkoc, Dumosh, Surkish, Lladoc, Balloçë
7	Herticë	Herticë, Surdull
8	Bërvenik	Bërvenik, Kalaticë, Illatë, Metergoc
9	Orilan	Orilan, Brainë, Kushevicë, Muhazoh, Rakinicë, Turuçicë, Brainë
10	Batllavë	Batllavë, Dyz, Gërdoc, Kaçybeg
11	Tërnavë	Tërnavë, Bellepojë, Halabak
12	Lupç i Poshtëm	Lupç i Poshtëm, Majac, Lupç i Epërm, Popovë
13	Lluzhan	Lluzhan, Godishnjak, Llogë, Sallabajë, Shakovicë
14	Gllamnik	Gllamnik, Buriçë, Konushëc, Penuhë, Siboc i Epërm, Siboc i Poshtëm
15	Llapashticë e Epërme	Llapashticë e Epërme, Katunishtë (Velikarekë), Llapashticë e Poshtme
16	Bajcinë	Bajcinë, Dobratin, Dobërdol, Bradash
17	Kërpimëh	Kërpimëh, Rrepë, Metehi, Pakashticë e Epërme dhe Poshtme, Zakut, Revuq
18	Pollatë	Pollatë, Potok, Dvorishtë, Slatinë, Reçicë
19	Zhiti	Zhiti, Sylevicë, Breçë, Tërnavicë, Murgull

Burimi: Përpunuar nga *Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025*, fq. 14.

Qytetarëve të komunës së Podujevës përveç që u ofrohen shërbime të mira në komunë, atyre u ofrohen edhe shërbime elektronike nëpërmjet E-kioskut. Po ashtu, duhet theksuar se me funksionalizimin e platformës shtetërore E-Kosova, shërbimet publike që gjenden në zyrat dhe sportelet fizike të

institucioneve ofrohen në mënyrë elektronike. Andaj, kjo ka lehtësuar shumë qasjen e qytetarëve/bizneseve në dokumentacionin përkatës.

INFRASTRUKTURA - komuna është përgjegjëse për mirëmbajtjen, organizimin, operimin dhe zhvillimin e rrjetit rrugor të saj. Andaj, një ndër sfidat kryesore për komunën është edhe mirëmbajtja e infrastrukturës publike.

Pozita gjeografike e komunës së Podujevës në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme nacionale, i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas, ku në nivel të komunës administrative janë të shtrira gjithsej 1,225 km rrugë të të gjitha kategorive. Nëse analizohet niveli i mbulueshmërisë së sipërfaqes së komunës me rrugë të të gjitha kategorive, rezulton se ato janë të shtrira në gjithsej 497.7 ha.

Komuna e Podujevës karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Shtrirja e rrugës nacionale Prishtinë – Merdar, kryesisht në pjesën qendrore dhe jug-lindore të komunës ia ka shtuar rëndësinë kësaj hapësirë.²⁷

Rrugët: Ekzistojnë katër kategori të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve nacionale e deri tek ato të pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Podujevës përbëhet nga:

- Rruga nacionale M-25: Prishtinë-Merdar: E lidhë Republikën e Kosovës dhe Republikën e Serbisë apo aksin rrugor Prishtinë-Podujevë-Merdar-Kurshumli, andaj cilësohet si rrugë nacionale. Rruga nacionale Prishtinë-Merdar kalon në pjesën qendrore dhe juglindore të komunës, e cila e përshkon atë në një gjatësi prej 18.8 km, si dhe lidhë 11 komuna kadastrale duke përfshirë edhe zonën urbane. Komunat kadastrale (vendbanimet) në të cilat kalon rruga nacionale M-25 janë: Lupç i Poshtëm, Shakovicë, Lluzhan, Penuhë, Kunushec, Gllamnik, Llapashticë e Poshtme, Podujevë, Shtedim,



²⁷ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 118.

Livadh dhe Merdar. Gjendja e rrugës nacionale M-25 në komunën e Podujevës, në përgjithësi konsiderohet e mirë.

- Rrugët regjionale: Rrugët e kësaj kategorie i mundësojnë komunës së Podujevës lidhje shumë të mirë në nivel regjional dhe kanë shtrirje në katër drejtime: R-129: Podujevë-Mitrovicë, R-128: Podujevë-Vushtrri²⁸, R-126: Podujevë-Pollatë, R-125: Podujevë-Orllan, R-127: Podujevë-Përpellac. Në komunën e Podujevës janë gjithsej 80 km rrugë regjionale ose 6.53% e totalit të rrugëve.

Rruga regjionale R-126 i mundëson komunës së Podujevës lidhje të mirë me rrugën nacionale Prishtinë-Merdar dhe rrugët regjionale R-129, R-125. Kjo rrugë i lidhë vendbanimet mjaft të rëndësishme si Batllavë, Shajkoc, Sfeçël, Surkish Podujevë, Obrançë, Peran, Bradash, Bajçinë, Dobërdol, Zakut, Pakashticë e Poshtme, skaji lindor i komunës kadastrave Revuq, Kërpimeh, skaji i komunës kadastrale Pakashticë e Epërme, Metehi, Repë dhe Pollatë.

- Rrugët lokale: rrugët të cilat i lidhin 78 zona kadastrale me gjithsej 78 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve. Në komunën e Podujevës janë gjithsej 370.1 km rrugë lokale ose 30.21% e totalit të rrugëve.
- Rrugë të pa kategorizuara: konsiderohen të gjitha sipërfaqet të cilat shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të zonave kadastrale. Gjithsej rrugë të kësaj kategorie në tërë territorin e komunës së Podujevës janë 756.3 km ose 61.73% e totalit të rrugëve.


Numri i banorëve që lidhen me rrugët nacionale e regjionale dhe kanë qasje të drejtpërdrejt në to është 66,475, ose rreth 75% e totalit të popullsisë së komunës. Pra, pjesa dërmuese e popullsisë kanë qasje në këto dy kategori të rrugëve. Kjo nga fakti se ato vendbanime që shtrihen përgjatë këtyre dy kategorive të rrugëve janë kryesisht vendbanime me numër më të madh të popullsisë në nivel komune, pra janë më atraktive për jetesë.²⁹

²⁸ Nuk është funksionale.

²⁹ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 118-122.

Komuna e Podujevës ka një rrjetë rrugore që shtrihet në gjithsej 1,225 km. Nga ky total, rrugë nacionale janë 18.8 km (1.53%), rrugë regjionale 80 km (6.53%), rrugë lokale 370.1 km (30.21%) dhe rrugë të pa kategorizuara janë 756.3 km (61.73%).

Graf. 12 Rrjeta e rrugëve në komunën e Podujevës



Burimi: Përpunuar nga *Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025*, fq. 118.

Disa nga projektet kapitale të përfunduara në vitin 2022 janë: asfaltimi i disa rrugëve në fshatrat Konushec, Lluga, Dyz, Bellopojë, Batllavë, Obrançë, Katunishtë, Orllan, Brainë, Turiqicë, Herticë, Brainë, Bradash, Dobratin, Llapashticë, Gllamnik, Sfeçël, Gërdoc, Lupç, Majac, Popovë, Tërnavë, Halabak, Bajçinë, Revuq, Peran, Letanc etj.

Ndërsa, projektet kapitale në proces e sipër janë: zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Skënderbeu" dhe ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistralla Podujevë-Prishtinë deri në rrugën "Vëllezërit Frashëri".²⁰

Rrjeti hekurudhor: Rrjeti hekurudhor në komunën e Podujevës është i karakterit nacional dhe ka shtrirje në pjesën qendrore të komunës së Podujevës, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit magjstral i cili lidhë dy shtete fqinjë (Republikën e Kosovës dhe Serbinë). Kjo linjë hekurudhore që kalon në pjesën qendrore të komunës së Podujevës, është një binarësh me gjatësi prej 22 km. Sigurisht se shtrirja e rrjetit hekurudhor e nivelit nacional ka një rëndësi shumë të madhe për komunën, si dhe ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin socio-ekonomik të saj. Janë 10 komuna kadastrale të cilat preken nga rrjeti, përkatësisht kanë qasje të drejtpërdrejt në këtë rrjet. Ato janë: Lupç i Poshtëm, skaji lindor i Majacit, Sallabaja, Lluzhani, Penuhë, Sibofci i Epërm, Surkishi, Podujeva, Livadica dhe Merdari (shih shtojcën 3). Shprehur në përqindje, 39% e popullsisë së Podujevës.²¹

Urat: Në komunën e Podujevës urat i takojnë dy kategorive të komunikacionit:

1. Rrugor: 96 ura dhe
2. Hekurudhor: 6 ura.

Nga 96 ura të cilat janë të ndërtuara në rrjetin rrugor të komunës, 6 prej tyre shtrihen në rrugën nacionale dhe 9 në rrugët regjionale. Urat e tjera shtrihen në rrugët lokale dhe rrugët e pa kategorizuara, të cilat kanë gjatësi prej 5 deri 20 m.

Në rrjetin hekurudhor të komunës së Podujevës janë të ndërtuara gjithsej 6 ura prej të cilave 1 në Lupç të Poshtëm, 2 në Lluzhan, 1 në Siboc i Epërm, 1 në Podujevë, 1 në Livadhi. Prej gjithsej 6 urave mbi rrjetin hekurudhor, 2 janë të ndërtuar mbi lumin Llap, dy mbi nacionale dhe 2 ura në rrjedhat tjera. Urat më të rëndësishme mbi rrjetin hekurudhor janë ato të ndërtuara mbi nacionale, në periferi të zonës urbane, me gjatësi prej 25 m, dhe mbi lumin Llap në Lupç të Poshtëm me gjatësi prej 55 m. Karakteristikë e komunikacionit



²⁰ Plani i punës së kryetarit 2022, fq. 8.

²¹ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 126.

hekurudhor është tuneli afër Merdarit (tuneli në komunën kadastrale të Merdarit me gjatësi prej 1500 m në rrjetin hekurudhor).

Transporti publik: Në komunën e Podujevës transporti publik konsiderohet se është mjaft mirë i organizuar. Të gjitha vendbanimet të cilat shtrihen në pjesën më të frekuentuar të komunës kanë qasje në transport publik nëpërmjet të autobusëve dhe kombi-busëve, ndërsa pa transport publik janë të gjitha ato vendbanime të cilat janë në zona të thella të komunës, ku përthyeshmëria e relievit është mjaft e madhe, si dhe numri i popullsisë së atyre vendbanimeve është mjaft i vogël.³²

Në bazë të dhënave nga INFRAKOS, planifikohet të vihet në funksion segmenti i rrjetit hekurudhor që kalon nëpër komunën e Podujevës, ku matjet gjeodezike kanë përfunduar, matjet gjeomekanike dhe projekti janë në proces. Me projektin e ri traseja e linjës do të mbetet e njëjta dhe do të shqyrtohen të gjitha 29 vendkalimet ekistuese për mundësinë e vazhdimit të statusit vendkalim, eliminim të disa prej tyre, por dhe nëse është e nevojshme hapje të ndonjë vendkalimit (disnivele) të ri.³³

TELEKOMUNIKACIONI - është transmetim i informacionit nga lloje të ndryshme të teknologjive mbi tela, radio, optike ose sisteme të tjera elektromagnetike.

Në vijim grafikun në vijim janë paraqitur rezultatet e anketimit nga ASK, lidhur me ekonominë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet në komunën e Podujevës.

Rezultatet e këtij anketimi tregojnë se vetëm 2.5% e ekonomive familjare në komunën e Podujevës posedojnë telefon fiks. Pjesa dërrmuese e tyre (88.8%) posedojnë vetëm telefon celular. Telefon fiks dhe celular kanë 7.7% e tyre, ndërsa as telefon fiks e as celular 1.0% e tyre.

Graf. 13 Ekonominë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet në komunën e Podujevës

³² Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 133.

³³ Harta zonale e komunës së Podujevës 2022-2030, fq. 74.

Telefonia fikse dhe mobile



Kompjuter personal



Burimi: ASKDATA: *Ekonomitë familjare private në bancia të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet, 2016.*

Sa i përket posedimit të kompjuterit personal, rezultatet e këtij anketimi tregojnë se 58.5% e ekonomive familjare në komunën e Podujevës e posedojnë së paku një të tillë dhe 41.5% nuk posedojnë. Prej ekonomive familjare që posedojnë kompjuter, 50.7% e tyre kanë qasje në internet nga njësia e banimit dhe 7.8% e tyre nuk kanë. Ndërsa, nga ekonomitë familjare që nuk kanë kompjuter, 1.5% e tyre shfrytëzojnë mundësitë alternative të qasjes në internet dhe 40.0% e tyre nuk kanë qasje fare.

RRJETI ENERGJETIK - Rrjeti i energjetikës në komunën e Podujevës është i mbuluar mirë shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, mirëpo gjendja e këtij rrjeti në drejtime të caktuara nuk është e mirë dhe kërkon intervenime. Nga gjithsej 110.2 km, sa ka gjatësi rrjeti energjetik i tensionit të lartë, 62.1 km (56.3%) e rrjetit energjetik gjendet në zonën aktive zhvillimore. Në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetit energjetik në të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10 kv në 20 kv.

Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike në përgjithësi në nivel komune duhet të bëhet edhe në segmentin e përmirësimit të infrastrukturës fizike me shtylla elektrike. Ky segment i infrastrukturës energjetike të komunës propozohet që në të gjitha drejtimet e shpërndarjes së energjisë elektrike të kapacitetit 20 KV, të bëhen në shtylla të betonit me gjatësi standarde (sipas standardeve të BE-së).²⁴

Komuna ka hartuar Planin Komunal të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) për periudhën 2019-2021. Objektivi i përgjithshëm i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë, rritja e nivelit të rehatisë dhe ulja e barrës së shpenzimeve të energjisë në buxhetin komunal të komunës së Podujevës.

Disa nga veprimet në formë të projekteve, masave të parapara me PKVEE përfshijnë:

- Fushata vetëdijësuese për banorët mbi rëndësinë e kursimit të energjisë;
- Ndërtimi i depon qendrore për biomasë;
- Aplikimi i masave të energjisë elektrike në ndërtesat e sektorit publik (ndërtesa e komunës, ndërtesën e Qendrës së punës sociale, objektet shkollore, ndërtesat e shëndetësisë), dhe;
- Aplikimi i masave në ndriçimin publik.²⁵

Mbulueshmëria aktuale me energji elektrike është paraqitur në shtojcën nr. 6.

²⁴ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 197.

²⁵ Harta zonale e komunës së Podujevës 2022-2030, fq. 70.

NDRIÇIMI PUBLIK - në zonën urbane të qytetit të Podujevës, ndriçimi me gjatësi prej 94.04 km, me gjithsej 2,580 trupa ndriçues ekonomik (efecientë). I gjithë ndriçimi është vendosur në 2,580 shtylla, prej tyre 1,072 shtylla të metalta dhe 1,469 shtylla të betonit. Ndërsa, ndriçimi publik në sheshet dhe parqet e qytetit të Podujevës është shtrirë në dy (2) sheshe dhe nëntë (9) parqe, me 973 trupa ndriçues ekonomik (efecientë). I gjithë ndriçimi është vendosur në 433 shtylla të metalta.



Sa i përket ndriçimit publik në zonat rurale (fshatra) të Podujevës, është shtrirë në 218 rrugë me gjatësi prej 191.9 km. Gjithsej 4,749 trupa ndriçues ekonomik (efecientë) janë vendosur në 4,749 shtylla, prej tyre 926 shtylla të metalta dhe 3,823 shtylla të betonit.

Ndërsa, gjatë vitit 2022 komuna e Podujevës ka zgjeruar rrjetin e saj të ndriçimit në fshatrat në vijim: Siboc i Epërm, Siboc i Poshtëm, Dumnicë, Dumnicë e Epërme, Godishnjak.²⁶

FURNIZIMI ME UJË - Furnizimi me ujë të pijshëm në mënyrë të organizuar në komunën e Podujevës daton që nga vitet '50-ta. Nga ky sistem furnizohej qyteti i Podujevës si dhe pjesa jugore e komunës.

Sot, komuna e Podujevës furnizohen me ujë nga dy drejtime:

- Nga fabrika e ujit në Shajkocv , dhe
- Nga sistemet e pompimit nga puset e Peranit.

Sistemi i ujësjellësit qendror të Podujevë menaxhohet nga KRU "Prishtina", njësi operative e ujësjellësit Podujevë. Ujësjellësi aktualisht disponon me 100 litra/sec dhe ate 80 l/sec nga akumulacioni në Batllavë i cili ndodhet në zonën "turizmi dhe natyra" dhe 20 l/sec të ujit nëntokësor nga puset e Peranit, të lokalizuara në pjesën "zona qendrore aktive". Nga ky sistem furnizohen 87,370 banorë ose 71.51% të popullsisë së komunës të cilët jetojnë kryesisht në pjesën e identifikuar si "zona qendrore aktive".

Në bazë të sasisë të ujit që është në dispozicion, konsumimi mesatar ditor për banor, vlerësohet të jetë përafërsisht 90-100 litra në ditë. Në proporcion me rritjen e numrit të banorëve për 10 vitet e ardhshme, nevoja për sasi të ujit të pijshëm do të jetë 265 litra/sec.

²⁶ Plan i punës së kryetarit 2022, fq. 9.

Në zonën "turizmi dhe natyra" ndodhet liqeni i Batilavës dhe fabrika e përpunimit të ujit në Shajkovc. Nga 10,853 banorë sa ka kjo zonë, 42.76% e tyre nuk furnizohet me ujë të pijshëm nga sistemi qendror por nga sistemet e vogla lokale dhe puse individuale. Ku 80% e ujit është jo i pijshëm për shkak të ndotjes bakterore me origjinë fekale. E tëra kjo është për arsye të mungesës së dezinfektimit dhe menaxhimit të këtyre resurseve. Kjo situatë e rëndon dukshëm standardin jetësor të banorëve të kësaj zone.

Në zonën e identifikuar si "malet dhe peizazhet", popullsia furnizohet me ujë të pijshëm nga sistemet e vogla lokale dhe puset individuale të cilat e marrin ujin nga burime natyrore dhe shpimet nëntokësore. Në këtë zonë jetojnë 22,207 banorë ose 18.18% e popullsisë. Cilësia e ujit në këtë zonë është jo e sigurt, rezultatet flasin për nivel të lartë të kontaminimit, 65% janë ujëra jo të pijshëm.

Meqenëse këto sisteme nuk menaxhohen nga ujësjellësi qendror dhe nuk dezinfektohen, nga aspekti shëndetësor paraqesin faktor rreziku permanent për banorët dhe e rëndojnë situatën epidemiologjike në këtë zonë.²⁷

Harta e infrastrukturës teknike – ujësjellësi është bashkëngjitur në shtojcën nr. 7.

KANALIZIMI - Në komunën e Podujevës, kanalizimi i ujërave të ndotura është shumë pak i zhvilluar përkundër investimeve të mëdha nga investimet e komunës të cilat janë kryer më parë. Ndërtimi i rrjetit është bërë pa ndonjë planifikim të mirëfilltë, varësisht prej nevojave të kohës dhe mjeteve në dispozicion dhe si i tillë përcillet me probleme dhe vështirësi të shumta. Aktualisht sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza është në menaxhim të njësisë operative të KRU "Prishtina", i cili ballafaqohet me vështirësi të shumta në mirëmbajtja e rrjetit për shkak të vjetërsisë, dimensioneve joadekuate të gypave, mosfunktionalitetit të tyre si dhe mospagesës së rregullt të shërbimeve.

Sot 85% të popullsisë së përgjithshme në komunë janë të mbuluar me këtë shërbim.

Ky sistem është i shtrirë kryesisht në "zona qendrore aktive" përkatësisht në pjesën urbane të qytetit të Podujevës, vendbanimin Letanc dhe pjesërisht në vendbanimin Peran. Ujërat e zeza pa asnjë trajtim paraprak shkarkohen në shtratin e lumit Llap duke shkaktuar ndotje të tij.

Në zonën "natyra dhe turizmi" asnjëri nga vendbanimet nuk kanë qasje në rrjetën e kanalizimit kolektiv dhe ujërat e zeza i derdhin në mënyrë të egër në lokacione të ndryshme në vendbanimet ku jetojnë. Kjo

²⁷ Plan i zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 200.

më së shumti ndikon në ndotjen e liqenit të Batllavës si rezervuar i ujit për pije për banorët e komunës Podujevës dhe Prishtinës.³⁸

Gjatë vitit 2021, komuna e Podujevës ndërtuar më shumë se 8 km kanalizim në qytet e fshatra.³⁹

Harta e infrastrukturës teknike – kanalizimi është bashkëngjitur në shtojcën nr. 8.

MBETURINAT - Në komunën e Podujevës shërbimin e menaxhimit të mbeturinave e kryen KRM "Pastrimi", shoqëria aksionare - Prishtinë, njësia operative në Podujevë, dhe operatori privat "Natyra" sh.p.k.. Këto kompani kryejnë shërbimet në zonën urbane dhe 90% të fshatrave. Në bazë të analizave të bëra ky shërbim është në nivel jo të kënaqshëm, vetëm 68.27% e amvisërive në komunë i shfrytëzojnë këto shërbime. Pas menaxhimit dhe organizimit të mbeturinave, kompania "Pastrimi" bënë edhe pastrimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferik. Ky rrjetë i gjatë 20-25 km është i shtrirë në zonën urbane dhe disa para lagje. Gjatë sezonit veror rrugët pastrohen çdo ditë në orët e natës. Uji për këtë qëllim merret nga pusi i kompanisë.

Harta e infrastrukturës teknike – mbulueshmëria me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave është bashkëngjitur në shtojcën nr. 9.

KULTURA – Komuna e Podujevës ka pozitë të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore-sportive. Në këtë komune zhvillohen një numër i madh i aktiviteteve të natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato kulturore, sportive, konferenca (për ambient, mjekësi, telekomunikacion etj), ku të rinjtë mundohet të përcjellin mesazhe të qarta tek shoqëria e gjithmbarshme. Të gjitha aktivitetet kulturore-sportive zhvillohen dhe organizohen në: Sallën e Kulturës, Palestrën Sportive, Stadiumin e Qytetit dhe Bibliotekën e Qytetit e në raste të veçanta shfrytëzohen edhe objektet shkollore dhe disa aktivitete mbahen edhe në ambient të hapur.⁴⁰

Qytetaret e Podujevës kanë traditë të gjerë në kultivimin e kulturës dhe artit. Dhënia e statusit dhe funksionalizimi i teatrit të qytetit "Avdush Hasani" është njëri ndër aktivitetet më të rëndësishme që është bërë për zhvillimin e jetës kulturore dhe artistike në Podujevë. Aktualisht teatri ka një strukturë

³⁸ Po aty, fq. 200-201.

³⁹ Raporti gjashtëmuor 2021 i komunës së Podujevës, fq 9.

⁴⁰ Po aty, fq. 51.

të mirë organizative dhe vazhdimisht punon në ofrimin e shfaqjeve teatrore dhe në zbulimin e artistëve të rinjë përmes edicioneve dhe kurseve të aktrimit. Ndër emblemat kryesore të kulturës në Podujevë është edhe festivali "Teatri Ndryshe" që është realizuar për me tepër se 10 edicione duke mbledhur dhe shfaqur performanca artistike nga mbarë Ballkani.

Podujeva ka gjithashtu shoqërinë kulturore dhe artistike "Josip Relat", kursin e kitarës "Mirela". Për më shumë janë të regjistruara edhe 18 organizata tjera në fushën kulturore dhe artit. Komuna e Podujevës në vazhdimësi subvencionin këto organizata me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së tyre. Megjithatë, njëra ndër sfidat mbetet mungesa e promovimit të vazhdueshëm të aktiviteteve kulturore dhe artistike në Podujevë.⁴¹

Komuna e Podujevës ka objekte të trashëgimisë kulturore që duhen ruajtur për vlerat e tyre kulturore dhe potencialin turistik në të cilat nuk duhet të lejohet zhvillimi i pakontrolluar. Vlerat e trashëgimisë kulturore duhen të konsiderohen rast pas rasti me qëllim rinovimin e objekteve në funksion të vlerës së tyre tradicionale, zhvillimin e qëndrueshëm në përputhje me funksionin e tyre kryesor⁴² (shih shtojcat nr. 10 dhe 11).

Një qendër e rëndësishme në kohën e Dardanisë në kohën romake ishte Vindenisi (Gllamniku i sotëm). Gjetjet arkeologjike janë ende të pranishme në shumë lagje të komunës, por lagjet me më së shumti mbetje që ekzistojnë sot janë në Gllamnik, Surkish, Popovë, Balloc etj.

Një nga monumentet arkeologjike me rëndësi vendore dhe kombëtare është sarkofagu i gjetur në Gllamnik, i cili ka vlerë kombëtare. Ky sarkofag është vendosur në Muzeun e Kosovës në Prishtinë.⁴³

Në listën e fundit të Trashëgimisë Kulturore nën Mbrotjtje të Përkohshme (2021-2022) janë përfshirë 14 monumente dhe lokalitete në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike dhe 23 monumente në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore. Po ashtu, janë përfshirë edhe 6 objekte të luajtshme, të cilat janë paraqitur në vijim.

Monumente të trashëgimisë arkeologjike në komunën e Podujevës janë: Lokalitet arkeologjik në Sallabajë (daton nga mesjeta) dhe Gërmadhat e kishës në Sallabajë (daton nga mesjeta).

⁴¹ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2020-2022, fq. 46.

⁴² Vlerësimi strategjik mjedisor i hartës zonale të komunës së Podujevës 2019-2027, fq. 87.

⁴³ Local Environmental Action Plan 2012-2017, fq. 35.

Si lokalitete të trashëgimisë arkeologjike janë listuar: Lokalitet arkeologjik - Maja e Llapit ('Vërhllab') në Bellasicë (antikitet i vonë); Varret e vjetra, gjurmët e kishës në Pollatë (antikitet i vonë, mesjetë); Lokaliteti Arkeologjik - Çuka e Braines (antikitet i vonë, mesjetë); Gërmadhat e Kishës, 'Perandori Konstantin dhe Perandoreshës Jelena' në Orllan (mesjetë); Kisha e vjetër e braktisur e Shën Arkangjel Mehillit në Rakinicë (mesjetë); Lokaliteti arkeologjik Vindenis 'Polanicë' në Gllavnik (romake, antikitet i vonë); Gërmadhat e kishës së Marisë së Zjarrit në Batllavë (mesjetë); Lokaliteti Arkeologjik - Kalaja (Qyteza) në Lupç të Poshtëm (antikë, antikë e vonë); Gërmadhat e kishës së Shën Arkangjelit në Bradash (mesjetë); Lokaliteti neolitik 'Gumnishtë' në Surkish (parahistori); Kalaja e Ballocit (antikë, antikë e vonë); Gërmadhat e Kishës së vjetër në Reqicë (mesjetë).

Monumentet e listuara të trashëgimisë arkitekturore janë: Kisha e Shën Andrejës në Podujevë (shek. XIX); Shtëpi Banimi në Podujevë (1935); Ndërtesa e Kuvendit Komunal në Podujevë (shek. XIX); Shtëpia e Kadri Metehisë në Metehi (shek. XVIII); Mulliri në Metehi (shek. XX); Pojata e Avdyll Shabanit në Metehi (shek. XX); Flladniku i Avdyll Shabanit në Metehi (shek. XX); Kulla e Xhemal Haxhiut në Herticë (shek. XIX); Shtëpi banimi - Avdullah Avdullahu në Llaushë të Ulnë Llaushë të Ulët (shek. XIX); Kishëz në Rakinicë (shek. XIX); Xhamia e Braines (shek. XVIII); Xhamia e Dumnicës (shek. XIX); Kulla e Nazif Muratit në Popovë (shek. XIX); Mulliri i Demë Ahmetit në Reqicë (shek. XIX); Shtëpi banimi - Sabit Hamiti në Reqicë (shek. XX); Kullë e Demë Ahmetit në Reqicë (shek. XX); Shtëpi banimi - Musa Hamiti në Reqicë (shek. XIX); Shtëpi banimi - Hasan Ramadani në Shajkocv (shek. XX); Mulliri në Majac (shek. XIX); Koshi i Basri Rrahmanit në Lladoc; Mulliri i lagjes Azemi në Pollatë (shek. XIX); Ish shkolla fillore në Orllan (1927-1928); Xhamia e Sibovcit.

Ndërsa, objektet e luajtshme janë gjetur të gjitha në Gllavnik (Vindenis): Një shishe (shek. II-IV); Një kupë (shek. II-IV); Një vazo (shek. II-IV); Dy broke (antikitet i vonë, shek. IV-VI); Një bylyzyk (antikitet i vonë, shek. IV-VI).

Fig. 5 Disa gjetje në lokalitetin arkeologjik të Vindenisit



a) Mozaiku i Orfeut

b) Shishe qelqi c) Sarkofag mermeri d) Unazë ari

Burimi: Archaeological Guide of Kosovo, fq. 62.

Një ndër tre stacionet rrugore që u ndërtuan në Dardani gjatë periudhës romake, është identifikuar stacioni Vindenis. Ky lokalitet arkeologjik gjendet në zonën e fshatit Gllamnik, komuna e Podujevës. Lokaliteti ndodhet afërsisht 5 km në jug, në juglindje nga Podujeva. Rruga e lashtë romake *Via Lissus-Naissus* (Lezhë-Nish) ishte një rrugë diagonale, që lidhte rajonin qendror të Ballkanit me bregdetin e Adriatikut, i cili kalonte përmes Vindenisit. Vendbanimi dhe stacioni rrugor romak i Vindenisit shtrihen në bregun e djathtë të lumit Llap, duke kapur një sipërfaqe pak a shumë prej 15-20 ha.

Gjatë viteve të 80-ta të shekullit të kaluar, gërmimet sistematike arkeologjike të kryera në këtë vend, zbuluan një sipërfaqe prej 550 m². Ndër gjetjet dhe veçoritë e regjistruara arkeologjike, më karakteristike janë varret me sendet e varreve. Ritet e varrimit të dokumentuara na tregojnë për praktikën e riteve të varrimit me djegie dhe inhumim. Përveç kësaj, u zbuluan disa tonë sarkofag të rëndë mermeri, shumica ndoshta posaçërisht të përgatitur për një person të shquar me status të lartë ekonomik, social dhe politik. Megjithatë, hetimet arkeologjike identifikuan disa banesa, dhe në veçanti një zbulim i dalluar i një mozaiku dyshemeje të përbërë me motive gjeometrike, në pjesën qendrore të mozaikut paneli figurativ i Orfeut e bën këtë mozaik një zbulim të veçantë.

Gjetje tjetër e zbuluar në këtë vend, është një unazë martese prej ari me një gur që tregon qartë dridhjen e duarve të djathta (*dextrarum iunction*), që do të thotë një marrëveshje, por gjithashtu simbolizon besnikërinë dhe miqësinë.

Sondazhet gjeofizike, gjeomagnetike apo prospeksionet e kryera në këtë lokalitet në vitet 2008 dhe 2011, në një sipërfaqe prej të paktën 11 hektarësh të këtij lokaliteti të rëndësishëm arkeologjik, identifikuan

gjurmë të mbetjeve të objekteve të ndryshme që në përshtypjen e parë ngjajnë me një garnizon ushtarak fushor, me gjasë i vendosur aty për të mbrojtur zonën përreth dhe stacionin rrugor. Lokaliteti arkeologjik i Vindenisit ka qenë aktiv gjatë gjithë periudhës së sundimit romak sisi dhe gjatë antikitetit të vonë.⁴⁴

Fig. 6 Koka antropomorfe e modeluar nga balta e përpunuar dhe e pjekur, e zbuluar në Surkish (gjetje rastësore)



Vendndodhja e identifikuar neolitike e Surkishit vetëm disa kilometra në jug-juglindje nga qyteti i Podujevës, vendosur në fshatin Surkish. Është një zonë me përmasa të panjohura dhe shtresimi arkeologjik është ende e pastudiuar, ndërkohë që deri më tani nuk ka pasur llogore apo gërmime provuese.⁴⁵

Burimi: Archaeological Guide of Kosovo, fq. 30.

Sipas të dhënave nga ASK (2019 dhe 2020), në komunën e Podujevës gjatë vitit 2019 janë dhënë 18 shfaqje teatrale, ndërsa gjatë vitit 2020 vetëm 4 shfaqje teatrale. Vërehet një rënie e madhe prej 77.8% në vitin 2020. Ndërsa numri i shfaqjeve të koncerteve në të dy vitet ka qenë i njëjtë, 2.

Bazuar në të njëjtin burim, numri i vizitorëve në muzeun e komunës së Podujevës gjatë vitit 2019 ishte 4,000. Ndërsa, numri i lexuesve në bibliotekën e qytetit gjatë vitit 2020 ishte 1,120. Duhet të theksohet se biblioteka ka 39,820 tituj, prej tyre 1,861 tituj janë hyrje e re në vitin 2020.

Rishtazi komuna e Podujevës ka nënshkruar Memorandum të bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) për projektin "Ndërtimi i Qendrës multifunktionale në Podujevë", që do të implementohet gjatë viteve 2022/2023. Për realizimin e këtij projekti MKRS-ja siguron mbështetje financiare në vlerë prej një milion euro.

⁴⁴ Burimi: Archaeological Guide of Kosovo, fq. 62.

⁴⁵ Burimi: Archaeological Guide of Kosovo, fq. 30.

PROFILI EKONOMIK I KOMUNËS SË PODUJEVËS – Është vlerësuar se zhvillimin më të hovshëm shoqëror dhe ekonomik, komuna e Podujevës e ka arritur në vitet e 80-ta. Në këtë periudhë veprimtarinë e vet e kanë zhvilluar 16 organizata ekonomike shoqërore me rreth 2,500 punëtorë. Gjatë viteve të 90-ta u themeluan rreth 200 ndërmarrje me kapital privat, kryesisht nga lëmi i tregtisë dhe shërbimeve. Gjatë luftës, të gjitha këto ndërmarrje u shkatërruan.

Pasojat ekonomike të konfliktit të fundit kanë qenë të rënda dhe kanë ndikuar në shkatërrimin e shumë ndërmarrjeve në pronësi shoqërore. Shumica e ndërmarrjeve tregtare ndërprejnë aktivitetin e tyre, ndërsa në ato që kanë mbetur janë të punësuar përafërsisht 400 persona. Dëmet që ka pësuar komuna e Podujevës në luftën e fundit kapin shumën prej 350 milion euro. Në periudhën e pasluftës, qoftë me ndihmën e donatorëve, por më tepër me financim vetanak, ka filluar veprimtaria ekonomike dhe sipas evidencës në komunën e Podujevës në fund të vitit 2002 kanë qenë të regjistruara 2,251 biznese. Komuna e Podujevës ka një bazë mjaft të mirë të zhvillimit ekonomik, bazuar në resurset ekzistuese.⁴⁶

Edhe sot, në këtë komunë ekziston mundësia e zhvillimit të shumë sektorëve ekonomik, filluar nga veprimtaritë primare ekonomike, ato sekondare, terciare e shërbyese. Sipërfaqet e konsiderueshme me tokë bujqësore, pyje, ara, livadhe e kullosa, ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve primare ekonomike. Gjithashtu, kjo komunë ka bazë të mirë edhe në veprimtari industriale, ndërsa bukuritë natyrore e sidomos liqeni i Batllavës ofrojnë mundësi të mirë për zhvillimin e turizmit.⁴⁷

Komuna e Podujevës karakterizohet me tri zonat (tërësi) kryesore hapësinore si: Malet dhe Peizazhet, Natyra dhe Turizmi si dhe Qendra, të cilat dallohen nga aspekti i zhvillimit demografik, ekonomik, social, mjedisor, i infrastrukturës dhe shërbimeve.

Tërësia *Malet dhe Peizazhet* është e dominuar nga sipërfaqet e tokës bujqësore të punueshme e pyjore, livadhe dhe kullosa, të cilat së bashku krijojnë peizazhe tërheqëse. Potenciali zhvillimor janë: pylltaria, blegtoria, bletaria dhe turizmi. Tërësia përfshin 28 vendbanime rurale që janë nën administrimin e nën qendrës Kërpimëh dhe bashkësive lokale: Pollatë dhe Zhiti.

⁴⁶ Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2003-2006, fq. 6 (cituar në *Planin zhvillimor të komunës së Podujevës 2016-2025*, fq. 104).


⁴⁷ *Planin zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025*, fq. 176.

Tërësia *Natyra dhe Turizmi* zhvillimi i së cilës drejtohet kah bujqësia, blegtoia, pylltaria. Është e dominuar kryesisht me pyje dhe kullosat, uji-liqeni, peizazhet natyrore atraktive për rekreacion dhe turizëm. Në këtë tërësi përfshihen 16 vendbanime rurale që janë nën administrimin e nënqendrës Orllan dhe bashkësive lokale: Herticë, Bërvenik, dhe Batllavë.

Tërësia *Qendrore-Aktive* konsiderohet si zona që ka potencialin më të madh për një zhvillim më të hovshëm ekonomik në fushën e bujqësisë, industrisë, bizneseve, turizmit, shërbimet etj. Në këtë pjesë janë të koncentruara pjesa më e madhe e vendbanimeve, popullsisë, shërbimeve, komunikacionit etj.⁴⁸

Bazuar në statistikat e ASK (2011), burimet kryesore të jetesës në komunën e Podujevës janë si vijon: 18.2% (16,143) e tyre kanë burim kryesor punën, 0.4% (372) e tyre si burim kryesor kanë patundshmëritë (qira, interes etj.), pastaj 5.8% (5,167) e tyre janë pensionistë, 3.9% (3,478) jetojnë nga ndihmat sociale, 0.2% (187) e tyre si burime kryesore kanë përfitimet nga sëmudjet, papunësia, pushimi i lehonisë etj., 3.8% (3,376) si burim kryesor të jetesës kanë remitancat, 63.5% (56,070) e tyre mbështeten nga personat tjerë dhe 4.2% (3,706) nga burimet tjera.

Graf. 14 Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës në komunën e Podujevës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës, 2011.*

⁴⁸ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 14-15.

Bizneset: Sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, numri i bizneseve të regjistruara në komunën e Podujevës deri më tani është 2,889. Prej tyre, 1,994 (69.02%) biznese individuale, 883 (30.56%) shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, 6 (0.21%) ortakëri e përgjithshme, 4 (0.14%) degë në Kosovë dhe shoqëri aksionare 2 (0.07%).

Po ashtu, sipas të njëjtës agjenci, biznese të shuara në tri vitet e fundit janë: 2020 (36), 2021 (45) dhe deri në fund të gushtit 2022 (28).

Ndërsa, numri i ndërmarrjeve të regjistruara në komunën e Podujevës në vitin 2021 ishte 354 (2.3% më shumë se në vitin 2020 (346) dhe 3.5% më shumë krahasuar me vitin 2019 (342). Ndërsa, numri i ndërmarrjeve të shuara përgjatë vitit 2020 në këtë komunë ishte 46, ndërsa në vitin 2019, 58 (20.7 % më pak krahasuar me vitin 2019).

Informata më të hollësishme sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike për vitin 2020 janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tab. 6 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe shuara sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike, 2020


Nr.	SEKTORËT DHE AKTIVITETET EKONOMIKE	REGJISTRUARA	SHUARA
1	Bujqësi, pylltari dhe peshkatori	32	1
2	Xehetari dhe gurëthyes	1	1
3	Prodhim	49	7
4	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	-	-
5	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizeimi të tokës	1	-
6	Ndërtimtari	38	4
7	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	106	17
8	Transport dhe ruajtje	14	2
9	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	38	2
10	Informacion dhe komunikim	12	5
11	Aktivitete financiare dhe sigurimit	2	1
12	Aktivitete të patundshmërisë	-	-
13	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	11	1
14	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	12	-
15	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	-	-
16	Arsim	2	-
17	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	5	1
18	Art, zbavitje dhe rekreacion	5	-
19	Aktivitete të shërbimeve tjera	18	4
Gjithsej		346	46

Burimi: ASK: *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021*, fq. 205-206.

Edhe në këtë komunë, numri në rritje i bizneseve nuk ka reflektuar në përmirësimin e dukshëm të ekonomisë së komunave dhe uljen e papunësisë për shkak se shumica e bizneseve janë me veprimtari jo prodhuese.⁴⁹

Shfrytëzimi i tokës: Në komunën e Podujevës shfrytëzimi i tokës është i ndarë në 12 kategori si në vijim.

Graf. 15 Shfrytëzimi i tokës në komunën e Podujevës



Burimi: Përpunuar nga *Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025*, fq. 74.

⁴⁹ Strategjinë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 22.

Bujqësia: Sipas të dhënave nga ASK-ja (2014), në komunën e Podujevës 24,807 ha është sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore (*shih hartën zonale të shfrytëzimit të tokës bujqësore në shtojcën 12*). Prej tyre toka të punueshme (ara) janë 12,317 ha. Kulturat e drithërave zënë sipërfaqe totale prej 9,034 ha, ku kultura e grurit dominon me sipërfaqe prej 6,767 ha, pas saj vjen kultura e misrit me rreth 1,797 ha dhe kultura e tërshërës me rreth 426 ha. Elbi dhe thekra kultivohen më pak. Ndërsa, nga kulturat bishtajore dominon fasulja me sipërfaqe prej 375 ha, pas saj vijnë bishtajoret tjera. Patatet kultivohen në një sipërfaqe prej 310 ha, ndërsa kulturat foragjere (jonxha, tërfili, misri i gjelbër etj.) në sipërfaqe prej 1,701 ha.



Nga viti 2010 e deri më tani, në Drejtorinë e Bujqësisë janë regjistruar 5,400 fermerë, prej tyre rreth 2,100 (38.9%) janë ende aktiv.

Sipas ASK-së (2014), numri i ekonomive bujqësore për perime në komunën e Podujevës është 3,099 me gjithsej sipërfaqe prej 417.09 ha. Prej tyre dominon kultura e specit me 123 ha, pastaj lakra me 78.5 ha, qepa me 69 ha, domatja me 42 ha, karrota me 32 ha, spinaqi me 11 ha, trangulli me 7 ha, kungull misiri (vidimi) me 7.4 ha, preshi me 6.6 ha etj.

Numri i ekonomive bujqësore që merren me kulturat e pemëve është 538 dhe shtrihen në sipërfaqe prej 184.4 ha. Prej tyre dominon kultura e mollës me 71.26 ha, pastaj kumbulla me 50.76 ha, dardha me 8.87 ha, qershë me 7.25 ha, vishnje me 4.68 ha etj. (ASK, 2014).

Sipas të dhënave statistikore nga ASK, në vitin 2014 komuna e Podujevës posedonte gjithsej 4,401 traktorë. Prej tyre, 545 (12.4%) me vjetërsi 0-10 vjet dhe 3,856 (87.6%) mbi 10 vjet. Siç shihet, kemi

Blegtoria dhe shpeztaria: Sipas të dhënave nga ASK (2014), komuna e Podujevës në vitin 2014 ka numëruar gjithsej 14,624 gjedhe, 7,528 dele, 630 dhi, 65 kuaj, gomarë dhe mushka. Ndërsa, 5,084 koshere bletësh.

Po ashtu, sipas të dhënave dhe statistikave nga ASK (2014), komuna e Podujevës në vitin 2014 ka numëruar gjithsej 149,468 shpezë. Prej tyre, pula për vezë 107,730 (72.1%), zogj, pula dhe gjela 32,131 (21.5%), zogj për majmëri 3,817 (2.6%), biba 3,008 (2.0%), rosa dhe pata 1,194 (0.8%) dhe të tjera 1,588 (1.1%).

Pylltaria: Sipërfaqja e tërësishme pyjore në komunën e Podujevës 29,680 ha (*më gjerësisht shih shtojcën nr. 13*). Fondi i drurit industrial është i vogël dhe kryesisht fondi ekzistues përdoret për nevoja të djegies

ose ngrohjes për banorët lokal si dhe për nevojat e ndërtimitarisë dhe më pak për punimin e artizanateve dhe veglave të punës.³⁰

Turizmi: Potencialet e shumta si geomorfologjia e territorit komunal e karakterizuar me dy masive malore si Kopaoniku dhe Gollaku, si dhe fushëgropa e Llapit së bashku me lumin Llap dhe liqenin e Batllavës, monumentet natyrore dhe ato kulturore, numri i madh i shërbimeve hoteliere i japin vlerë konkurruese komunës së Podujevës në Kosovë, që mund të jenë bazë për zhvillimin e turizmit vikendor dhe rural.³¹ Më gjerësisht, shih hartën e zonave turistike në shtojcën nr. 14.

Duhet theksuar se komuna e Podujevës është në finalizim të strategjisë së zhvillimit të turizmit.

Fig. 6 Liqeni i Batllavës



³⁰ Plani zhvillimor i komunës së Podujevës 2016-2025, fq. 110.

³¹ Vlerësim strategjik mjedisor i hartës zonale të komunës së Podujevës 2019-2027, fq.54 .

BUXHETI KOMUNAL – Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Podujevës është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, që pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike për të përmbushur objektivat e përcaktuara zhvillimore të komunës së Podujevës. Pra, KAB paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare.³²

Disa nga vështirësitë që janë përballur komunat në Republikën e Kosovës janë: mungesa e një fondi adekuat qendror për investime kapitale të nxitur nga projektet i cili do të menaxhohej nga qeveria sipas një sistemi të unifikuar, mungesa e një tregu kreditor që do t'i mundësonte komunave qasjen në fonde për zhvillim me kamata të ulëta, mungesa e mekanizmit për fondet për emergjenca të paparashikuara. Ekziston një dallim i madh ndërmjet kapacitetit ekonomik të komunave, për gjenerimin e të hyrave vetanake (mesatarisht 18%) dhe i grantit nga Buxheti i Kosovës (mesatarisht 82%).³³

Buxheti i komunës së Podujevës sigurohet nga dy burime kryesore: grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Buxheti i komunës për vitin 2022 është 23,449,520.0 €. Nga qeveria qendrore janë siguruar 21,963,055.0 €, ndërsa nga të hyrat vetanake janë planifikuar të sigurohen 1,486,465.0 €.

Edhe komuna e Podujevës vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë rreth 93% të buxhetit total të komunës.³⁴ Më detajishti shih tabelën dhe grafikun në vijim në vijim.

Burimet e financimit: Përbëhen nga të hyrat vetanake të komunës, grantet qeveritare, grantet e donatorëve të jashtëm dhe huamarrja komunale.

Të hyrat vetanake komunale janë mjetet financiare që mbliidhen nga taksat, tarifat, gjobot, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, ato nga ndërmarrjet komunale, bashkë pagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj.³⁵



³² Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Podujevës 2023-2025, faqe 2.

³³ Strategjinë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 23.

³⁴ Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Podujevës 2023-2025, faqe 7.

³⁵ Ligji nr. 03/l-049 për financat e pushtetit lokal.


Komunat pranojnë grante operative nga Buxheti i Konsoliduar i Republikës së Kosovës. Grantet operative janë: grantet e përgjithshme, grantet specifike për arsimit dhe grantet specifike për shëndetësi. Në vitin 2022, gjithsej granti qeveritar për komunën e Podujevës ishte 21,963,055.0 €. Prej tyre, granti i përgjithshëm 9,160,666.0 € ose shprehur në përqindje 41.7% e grantit qeveritar, granti i arsimit 9,728,422.0 € (44.3%) dhe granti i shëndetësisë 3,073,967.0 € (14.0%).

Tab. 7 Burimet e financimit në komunën e Podujevës (€), periudha 2023-2025

BURIMI I TË HYRAVE	2022	Planifikimi 2023	Vlerësimi 2024	Vlerësimi 2025
Granti i përgjithshëm	9,160,666.0	12,119,450.0	13,000,657.0	13,862,676.0
Granti i arsimit	9,728,422.0	9,859,607.0	10,573,638.0	10,616,588.0
Granti i shëndetësisë	3,073,967.0	3,330,767.0	3,497,305.0	3,672,171.0
Gjithsej granti qeveritar	21,963,055.0	25,309,824.0	27,071,600.0	28,151,435.0
Shërbimet rezidenciale	/	160,000.0	175,000.0	175,000.0
Teatri "Avdush Hasani"	130,249.0	130,249.0	/	/
Të hyrat vetanake	1,356,216.0	1,806,493.0	1,883,659.0	1,966,658.0
GJITHSEJ BUXHETI	23,449,520.0	27,406,566.0	29,130,259.0	30,293,093.0

Burimi: Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Podujevës 2023-2025, faqe 5.

Graf. 16 Mesatarja e burimeve të financimit në komunën e Podujevës (%), periudha 2023-2025



Bazuar në të dhënat e tabelës nr. 6, kemi kalkuluar mesataren e grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake për periudhën 2023-2025 dhe ka rezultuar si në vijim: Mesatarisht 93.0% e buxhetit të komunës së Podujevës bazohet në grantin qeveritar dhe mesatarisht 7.0% në të hyrat vetanake.

Burimi: Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Podujevës 2023-2025, faqe 5.

Tab. 8 Planifikimi i të hyrave vetanake në komunën e Podujevës (€), 2023-2025

STRUKTURA E TË HYRAVE VETANAKE	2023	%	2024	%	2025	%
Tatimi në pronë	438,616.0	24.3	447,388.0	23.8	458,573.0	23.3
Tatimi në tokë	319,872.0	17.7	335,866.0	17.8	352,659.0	17.9
Taksat komunale	681,005.0	37.7	731,005.0	38.7	788,426.0	40.1
Ngarkesat komunale	227,000.0	12.6	227,000.0	12.1	227,000.0	11.5
Të hyrat tjera	80,000.0	4.4	82,400.0	4.4	80,000.0	4.1
Gjobat e gjykatës	60,000.0	3.3	60,000.0	3.2	60,000.0	3.1
GJITHSEJ	1,806,493.0	100.0	1,883,659.0	100.0	1,966,658.0	100.0

Burimi: Adaptuar nga: *Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Podujevës 2023-2025, faqe 6-7.*

Në tabelën e paraprake është paraqitur struktura e planifikuar e të hyrave vetanake të komunës për periudhën 2023-2025. Siç shihet në tabelën e mësipërme, mesatarisht 92.5% e të hyrave vetanake në komunën e Podujevës planifikohen të jenë të hyra nga administrata komunale për këtë periudhë. Të hyrat tjera janë planifikuar të jenë mesatarisht 4.3% dhe gjobat e gjykatës 3.2%.

Struktura e shpenzimeve: Siç shihet në vijim, shpenzimet rrjedhëse janë mesatarisht 63.7% të shpenzimeve komunale dhe ato kapitale mesatarisht 36.3%. Nga shpenzimet rrjedhëse, më të lartat janë ato për paga dhe mëditje, pastaj shpenzimet për mallra dhe shërbime, subvencionet dhe shpenzimet komunale.

Tab. 8 Struktura e shpenzimeve buxhetore në komunën e Podujevës (€), vlerësim për periudhën 2023-2025

STRUKTURA E SHPENZIMEVE BUXHETORE	2023	%	2024	%	2025	%
Pagat dhe mëditjet	12,969,636.0	71.6	12,969,636.0	70.4	12,969,636.0	69.3
Mallrat dhe shërbimet	3,556,899.0	19.6	3,842,563.0	20.8	4,000,864.0	21.4
Subvencionet	1,600,050.0	8.8	1,630,050.0	8.8	1,750,050.0	9.3
<i>Gjithsej shpenzime rrjedhëse</i>	<i>18,126,585.0</i>	<i>100.0</i>	<i>18,442,249.0</i>	<i>100.0</i>	<i>18,720,550.0</i>	<i>100.0</i>
<i>Shpenzimet rrjedhëse</i>	<i>18,126,585.0</i>	<i>66.1</i>	<i>18,442,249.0</i>	<i>63.3</i>	<i>18,720,550.0</i>	<i>61.8</i>
<i>Shpenzimet kapitale</i>	<i>9,279,981.0</i>	<i>33.9</i>	<i>10,688,010.0</i>	<i>36.7</i>	<i>11,572,543.0</i>	<i>38.2</i>
GJITHSEJ	27,406,566.0	100.0	29,130,259.0	100.0	30,293,093.0	100.0

Burimi: Adaptuar nga: *Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Podujevës 2023-2025, faqe 24.*

Graf. 17 Struktura mesatare e shpenzimeve në komunën e Podujevës (%), vlerësim për periudhën 2023-2025



Burimi: Adaptuar nga: *Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Podujevës 2023-2025, faqe 24.*

3. ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është një nga veglat e shumta të disponueshme që ndihmon procesin e planifikimit strategjik. Kjo vegël lehtëson diskutimet e nevojshme për zhvillimin e një plani strategjik komunal.

Kjo analizë niset nga ideja themelore e analizës së faktorëve të brendshëm dhe faktorëve të jashtëm. Analiza e faktorëve të jashtëm të komunës përfshin analizën e mundësive "O" dhe rreziqeve "T". Ndërsa, analiza e faktorëve të brendshëm përfshin analizën e përparësive "S" dhe të dobësive "W" të vetë komunës.

Resurset e një komune dhe cilësia e performancës së saj janë zakonisht faktorë që bëhen pika të forta ose të dobëta të saj. Ndërsa, mundësitë dhe rreziqet janë faktorë dhe tendenca të tregut që mund të përfitojnë ose dëmtojnë planet aktuale të komunës.


Të gjithë faktorët identifikohen dhe listohen sipas perceptimit të grupit punues pas analizave të të gjitha sferave të nevojshme.

Analiza SWOT gjen aplikim në një sërë situatash. Mund të aplikohet për vlerësimin e realizueshmërisë së opsioneve të ndryshme të disponueshme si zgjidhje për një problem ose sfidë të veçantë. Mund të zbatohet gjithashtu për identifikimin e mundësive dhe për t'i peshuar ato kundrejt rreziqeve të afërta dhe për të arritur në një vendim përfundimtar. Analiza SWOT ndihmon komunat në përcaktimin e faktorëve që do të funksionojnë në favor të tyre dhe atyre që do të punojnë kundër tyre në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të dëshiruara.

Andaj, rezultatet e analizës SWOT janë të dobishme në procesin e planifikimit strategjik. Çështjet e identifikuar gjatë kësaj analize do të mbështesin krijimin e vizionit, qëllimeve strategjike, objektivave dhe hartimin e programeve dhe projekteve që do të maksimizojnë pikat e forta, do të adresojnë dobësitë, do të përfitojnë nga mundësitë dhe do të zbusin rreziqet.

Rrjedhimisht, vlerësimi i përmblendhës i gjendjes së komunës së Podujevës është bërë duke përdorur analizën SWOT.

Në matricën në vijim janë paraqitur përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e dala nga analiza e mësipërme e vlerësimit të gjendjes aktuale në komunën e Podujevës. Renditja e tyre është bërë krahas informatave të nxjerra sipas rrjedhës së renditjes të pjesëve të analizuara.



S**Përparësitë**

- Moshë e re e popullsisë
- Pozitë e volitshme gjeografike
- Lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore
- Vendkalim kufitar
- Resurse ujore – lumi Llap dhe liqeni i Batllavës
- Sipërfaqe cilësore të tokës bujqësore
- Sipërfaqe të madhe të livadheve dhe kullosave
- Kushte të mira klimatike për bujqësi e blegtori etj.
- Traditë të veçuar në zhvillimin e tregtisë
- Trashëgimi të pasur kulturore dhe historike
- Trashëgimi të pasur arkeologjike dhe arkitekturore
- Resurse turistike
- Bashkëpunimi me qytetarë
- Vlera të etaljuara të orientimit në shërbime, rezultate, logjistikë, profesionalizëm dhe integritet
- Qasja relativisht e mirë e qytetarëve në transportin publik
- Investimi i vazhdueshëm në urbanizëm dhe infrastrukturë fizike

O**Mundësitë**

- Promovimi i resurseve natyrore dhe trashëgimisë kulturore
- Natyrë dhe peizazhe të bukura për turizëm dhe rekreacion
- Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë nëpërmjet praktikave të reja bujqësore
- Zhvillimi i turizmit malor
- Gatishmëria e banorëve në bashkëpunim për projekte të komunës
- Organizimi i trajnimeve profesionale për t'i udhëzuar bizneset e reja dhe ekzistuese rreth aplikimit për grante
- Rritja e inkasimit të të hyrave vetanake
- Shfrytëzimi i fondeve të BE-së dhe i skemave të granteve për zhvillim
- Apikimi i lehtësirave administrative komunale me qëllim të nxitjes së investimeve të huaja direkte
- Krijimi i fondit për subvencionimin e shpenzimeve të interesit për kreditë investive në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese
- Nxitja e rritjes së eksportit të produkteve vendore
- Subvencionimi i aktiviteteve kulturore
- Shfrytëzimi i mundësive nëpërmjet partneriteteve publiko-private si dhe nxitja e inovacionit
- Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe ruajtja e mjedisit

W**Dobësitë**

- Shkallë e lartë e popullsisë
- Numër i madh i qytetarëve që varen nga mbështetja financiare e të tjerëve
- Shkallë e lartë e varfërisë
- Furnizimi jo i mjaftueshëm me ujë të pijshëm
- Menaxhim jo i mirë i mbulueshmërisë me shërbime për mbeturina
- Mospërfundimi i linjës hekurudhore
- Ndërtime në tokat bujqësore
- Qasje e pamjaftueshme në fonde investive dhe zhvillimore
- Infrastrukturë jo e mirë në disa objekte arsimore dhe shëndetësore
- Infrastrukturë jo e mirë në vendbanimet kodrinore-malore
- Shumë km rrugë të pakategorizuara
- Dominimi i bizneseve me veprimtari tregtare dhe shërbyese
- Diferencë e dukshme ndërmjet kapacitetit ekonomik të komunave, për gjenerimin e të hyrave vetanake dhe i grantit nga Buxheti i Kosovës
- Mos shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në të gjithë vendbanimet
- Mos zhvillimi dhe mos promovimi i mjaftueshëm i zonave turistike dhe rekreacionit

T**Rreziqet**

- Rritje e dukshme e migrimit ndërkombëtar
- Ndotja dhe degradimi i mjedisit (pyjet, lumenjtë, tokat bujqësore)
- Zvogëlimi i vazhdueshëm i fondit të tokës bujqësore për shkak të ndërtimeve
- Teknologjia e vjetërsuar për punimin e tokës bujqësore
- Ekonomia joformale
- Konkurrencë jolojale si pasojë e prezencës së ekonomisë joformale
- Mungesë e interesimit të donatorëve për investime
- Interesi i lartë i kredive
- Vendbanime me probleme në infrastrukturë teknike
- Rënie e numrit të nxënësve nga viti në vit në të gjitha nivelet



4. VIZIONI, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT KYÇE

Pa dyshim, deklarata e vizionit dhe misionit, po ashtu dhe vlerat kyçe të komunës së Podujevës duhet të jenë të mishëruara në kornizën për përsosmërinë e performancës së saj.

Si pjesë e profilit të komunës së Podujevës është vizioni i saj. Po ashtu, misioni i komunës që reflekton arsyen e ekzistencës së komunës dhe mbështet realizimin e vizionit. Në mënyrë që të mbështetet misioni dhe arritja e vizionit të komunës, qëllimet dhe objektivat vendosen përmes procesit të planifikimit strategjik. Vlerat thelbësore mbështesin këto qëllime dhe objektiva, gjithashtu lidhin së bashku dhe përforcojnë të gjitha vendimet dhe veprimet themelore operationale.

Deklaratat e vizionit dhe misionit të komunës së Podujevës, janë prezantuar në vijim.



Pra, vizioni i komunës së Podujevës është: "Komunë e sukseshme me mundësi për të gjithë". Ndërsa, misioni i saj reflekton përkushtimin e komunës të ofrojë shërbime efektive që sigurojnë mirëqenie të qëndrueshme për qytetarët e saj.

Vlerat kyçe të komunës së Podujevës janë: **Bashkëpunimi** (bashkëpunimi i ndërsjellët komunal dhe me qytetarët e komunës, sektorin privat, shoqërinë civile, qeverinë qendrore dhe palët tjera të interesit), **orientimi në shërbime** (informimi dhe dëgjimi i qytetarëve duke ofruar shërbime të kënaqshme për ta), **orientimi në rezultate** (matja e performancës, marrja e masave korrigjuese të nevojshme që të arrihen qëllimet e përcaktuara), **llogaridhënia** (përgjegjësi për qeverisje komunale efektive dhe efektive), **integriteti** (kryerja e punëve me ndershmëri të lartë), **profesionalizmi** (mbështetja në standarde të larta, aftësi dhe kompetenca), **paanshmëria dhe drejtësia** (promovimi i drejtësisë duke eliminuar pabarazitë), **transparenca** (promovimi i punës së bazuar në transparencë).

Fig. 8 Vlerat kyçe të komunës së Podujevës



QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Në mënyrë që të mbështetet misioni dhe arritja e vizionit të komunës, qëllimet strategjike dhe objektivat specifike përcaktohen gjatë procesit të planifikimit strategjik. Pra, hapi i radhës në procesin e planifikimit strategjik është përcaktimi i qëllimeve strategjike të cilat specifikohen tutje në objektiva (nën qëllime) e të cilat specifikohen edhe më tej në projekte konkrete për implementim.

Çështjet kryesore me të cilat përballet komuna e Podujevës, janë identifikuar dhe përmbledhur në vijim si qëllime strategjike të SZHEL.

- Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i ambientit të të bërit biznes dhe aktiviteteve bujqësore (mbështetja e krijimit të bizneseve të qëndrueshme *(duke përfshirë gratë dhe të rinjtë)*; subvencionimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme që merren me bujqësi, blegtori dhe bletari; nxitja e investimeve të huaja direkte dhe tërheqja e investimeve të huaja direkte; funksionalizimi i zonës ekonomike; zhvillimi i eksportit të produkteve vendore dhe nxitja e inovacionit nëpërmjet Partneriteteve Publiko Private, inicimi i së paku katër projekteve).
- Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe mirëqenies sociale (ndërtimi i objekteve shkollore dhe sallave sportive; përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe investim në kabinete dhe teknologji bashkëkohore në shkolla; përmirësimi i kushteve të nxënësve; zhvillimi i aftësimit profesional; ngritja e kapaciteteve të Drejtorisë Komunale të Arsimit në planifikim strategjik dhe monitorim; përmirësimi i cilësisë në menaxhim dhe mësimdhënie nëpërmjet vlerësimit sipas metodologjisë 360°, ku nxënësit vlerësojnë mësimdhënësit, mësimdhënësit menaxhmentin e shkollës, menaxhmenti i shkollës mësimdhënësit; ndërtimi i qendrës rezidenciale; ndërtimi dhe renovimi dhe i objekteve shëndetësore; përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore dhe ndërtimi i qendrës për persona të moshuar, përkrahja e tyre dhe familjeve në nevojë).
- Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i urbanizmit dhe infrastrukturës teknike (ndërtimi, zgjerimi dhe asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse dhe mirëmbajtja e rrugëve të vjetra; ndërtimi i trotuareve dhe shtigjeve të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse; ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni, i kalesave të vogla në trotuare dhe i urave të vogla për këmbësorë; ndërtimi i urave me kalesa, i mureve mbrojtëse dhe meremetimi i rrugëve me zhavorr; vendosja e shenjzimeve horizontale dhe vertikale; ndërtimi i unazës së qytetit; ndërtimi i stacionit të autobusëve; zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit; zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra; shtrirja e shërbimit të

grumbullimit të mbeturinave; përmirësimi i shërbimeve të efikasitetit të energjisë dhe ndërtimi i parkingut nëntokësor).

- Zhvillimi i turizmit nëpërmjet promovimit të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit të pastër jetësor (përmirësimi i infrastrukturës së turizmit dhe rekreacionit; ndërtimi dhe rritja e hapësirave të parqeve, hapësirave të reja të gjelbëruara, kopshteve të hapura të lodrave për fëmijë; zhvillimi i turizmit nëpërmjet promovimit të trashëgimisë kulturore, resurseve natyrore, peizazheve; ndërtimi, renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore; ndërtimi i objekteve të reja kulturore dhe argëtuese dhe funksionalizimi i atyre ekzistuese; pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore; mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe ruajtja e mjedisit dhe zgjerimi, rregullimi dhe mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve).
- Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i funksionalitetit dhe efikasitetit të shërbimeve komunale (investimi në infrastrukturë publike; shërbime cilësore, efikase dhe transparente për qytetarët dhe bizneset; digjitalizimi i administratës etj.)

Në vijim janë prezantuar qëllimet strategjike, të cilat janë deshifruar tutje në objektiva specifike, e të cilat janë specifikuar më tej në projekte konkrete.

Qëllimi strategjik 1: Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i ambientit të të bërit biznes dhe aktiviteteve bujqësore

Objektivi specifik 1.1 Mbështetja e krijimit të së paku 15 bizneseve të qëndrueshme në vit (duke përfshirë gratë dhe të rinjtë).

Projekti 1.1.1 Organizimi i trajnimeve tre herë brenda vitit për të interesuarit për krijimin e bizneseve të reja.

Projekti 1.1.2 Organizimi i takimeve informuese dhe udhëzuese katër herë brenda vitit, për të interesuarit për fitimin e granteve (në aplikim dhe procedurat përcjellëse).

Projekti 1.1.3 Organizimi i takimeve konsultative për çështjet biznesore në mënyrë të vazhdueshme për bizneset e reja.

Projekti 1.1.4 Promovimi i bizneseve të reja të krijuara brenda vitit, nëpërmjet organizimit të panairove dhe organizimit të degustimit të produkteve të tyre.

Objektivi specifik 1.2 Subvencionimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme që merren me bujqësi, (drithëra, pemëtari dhe perimtari), blegtori dhe bletari.

Projekti 1.2.1 Përkrahje financiare për ngritjen e pemishteve.

Projekti 1.2.2 Përkrahje financiare për furnizimi me fidanë të pemëve të imëta si mjedër, dredhëz dhe manaferrë.

Projekti 1.2.3 Përkrahje financiare për ngritjen e serave të perimeve.

Projekti 1.2.4 Përkrahje financiare për kultivimin e kulturave lavértare.

Projekti 1.2.5 Përkrahje financiare për ngritjen e fidanishteve dhe lulishteve.

Projekti 1.2.6 Përkrahje financiare në kultivimin e bimëve, çajrave mjekuese kërpudhave.

Projekti 1.2.7 Krijimi i Fondit të ZHEL-it për mbështetje të bizneseve mikro dhe start up-ve.

Projekti 1.2.8 Përkrahje financiare fermerëve në përpunim të prodhimeve bujqësore.

Projekti 1.2.9 Ndërtimi i pikave grumbulluese të qumështit.

Projekti 1.2.10 Ndërtimi i fabrikës për përpunimin e qumështit.

Projekti 1.2.11 Përkrahje financiare fermerëve për ndërtimin e fermave me 15 krerë lopë përfshirë mekanizmin bujqësor.

Projekti 1.2.12 Përkrahje financiare fermerëve për ndërtimin e fermave deleve, dhenve, shpezëve përfshirë mekanizmin bujqësor.

Projekti 1.2.13 Ngritja e shoqërive të bletëve (50 shoqëri e më shumë bletësh).

Projekti 1.2.14 Përkrahja e fermerëve ë ndërrimin e mjeteve të vjetërsuara të punës, sidomos mekanizmave bujqësorë.

Projekti 1.2.15 Ndërtimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore në luginën e lumit Llap.

Projekti 1.2.16 Ndalimi i tjetërsimit të tokës cilësore bujqësore nga zhvillimet sipas dispozitave ligjore.

Projekti 1.2.17 Ndalimi i ndotjes së tokës bujqësore nga ndotësit e ndryshëm sipas dispozitave ligjore.

Projekti 1.2.18 Përkrahja e fermerëve dhe bujqve me trajnime.

Projekti 1.2.19 Organizimi i panairëve me qëllim të promovimit të prodhimeve lokale.

Objektivi specifik 1.3 Nxitja e investimeve të huaja direkte dhe tërheqja e së paku 6 milion € investime të huaja direkte.

Projekti 1.3.1 Identifikimi i investitorëve të huaj aktual sipas veprimtarisë, numrit të punëtorëve, qarkullimit deri në maj të vitit 2023.

Projekti 1.3.2 Identifikimi i së paku 50 investitorëve të huaj potencial, përfshirë edhe diasporën deri në shtator të vitit 2023.

Projekti 1.3.3 Përzgjedhja e së paku 25 investitorëve të huaj direkt dhe krijimi i kontakteve me ta, deri në nëntor të vitit 2023.

Projekti 1.3.4 Organizimi i së paku tri konferencave ku ftohen investitorët potencialë dhe krijohen lidhjet për nxitje të investimeve të mundshme në komunë.

Objektivi specifik 1.4 Funksionalizimi i zonës ekonomike.

Projekti 1.4.1 Funksionalizimi i zonës ekonomike.

Objektivi specifik 1.5 Zhvillimi i eksportit të produkteve vendore.

Projekti 1.5.1 Hartimi i listës së eksportit aktual sipas veprimtarisë, vëllimit dhe qarkullimit, deri në qershor 2023.

Projekti 1.5.2 Mbështetja e vazhdueshme e bizneseve që eksportojnë, me anë të ofrimit të mbështetjes për promovimin e produkteve, trajnimin për aplikimin e strategjive për depërtim në tregje të reja etj.

Projekti 1.5.3 Përkrahje e vazhdueshme institucionale në sigurimin e metodave dhe teknikave për eksport të prodhimeve bujqësore.

Objektivi specifik 1.6 Nxitja e inovacionit nëpërmjet Partneriteteve Publiko Private, inicimi i së paku katër projekteve.

Projekti 1.6.1 Formimi i grupit punues dhe kapaciteteve për Partneritete Publiko Private.

Projekti 1.6.2 Identifikimi i projekteve dhe përzgjedhja e katër projekteve potenciale për Partneritete Publiko Private.

Projekti 1.6.3 Sigurimi i fondeve për financimin e Studimeve të Fizibilitetit për projektet e përzgjedhura të Partneritete Publiko Private.

Projekti 1.6.4 Hartimi i studimit të fizibilitetit për katër projekte në Partneritete Publiko Private.

Qëllimi strategjik 2: Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe mirëqenies sociale

Objektivi specifik 2.1. Ndërtimi i objekteve shkollore dhe sallave sportive deri në fund të periudhës strategjike.

Projekti 2.1.1 Ndërtimi i shkollës në fshatin Obrançë.

Projekti 2.1.2 Ndërtimi i shkollës në fshatin Dumosh.

Projekti 2.1.3 Ndërtimi i shkollës në fshatin Lluga.

Projekti 2.1.4 Ndërtimi i shkollës së mesme.

Projekti 2.1.5 Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Enver Maloku".

Projekti 2.1.6 Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në shkollën "Shaban Shala".

Projekti 2.1.7 Ndërtimi i çerdhes në rrugën Fitorja.

Projekti 2.1.8 Ndërtimi i çerdhes në fshatin Lluzhan.

Projekti 2.1.9 Ndërtimi i çerdhes në fshatin Kërpimeh.

Objektivi specifik 2.2. Përmirësim i infrastrukturës fizike në shkolla, deri në fund të periudhës strategjike.

Projekti 2.2.1 Renovim i objekteve shkollore.

Projekti 2.2.2 Renovim i fushave sportive.

Projekti 2.2.3 Furnizim me inventarë në shkolla.

Objektivi specifik 2.3. Investim në kabinete dhe teknologji bashkëkohore në shkolla.

Projekti 2.3.1 Deri në vitin 2024, shkollat të pajisen me tabela digjitale.

Projekti 2.3.2 Krijimi i kabineteve dhe laboratorëve të kimisë, fizikës, biologjisë, informatikës dhe pajisja e tyre me mjete didaktike.

Objektivi specifik 2.4. Përmirësimi i kushteve të nxënësve.

Projekti 2.4.1 Ofrimi i shujtave për nxënësit e klasave 1-5.

Projekti 2.4.2 Organizimi i transportit për nxënësit e vendbanimeve të thella malore që udhëtojnë mbi 4 km në një drejtim nga shtëpia në shkollë.

Projekti 2.4.3 Rekrutimi i psikologëve për çdo shkollë.

Objektivi specifik 2.5. Zhvillimi i aftësimin profesional.

Projekti 2.5.1 Funkcionalizimi i qendrës për aftësim profesional.

Projekti 2.5.2 Ridestinimi i SHML në Batllavë si shkollë profesionale.

Projekti 2.5.3 Hartimi i kurrikulës për sektorin e turizmit në shkollat profesionale.

Objektivi specifik 2.6. Ngritja e kapaciteteve të Drejtorisë Komunale të Arsimit në planifikim strategjik dhe monitorim

Projekti 2.6.1 Zhvillimi i planit komunal për zhvillim të arsimit 2024-2028, deri në fund të muajit gusht të vitit 2023.

Projekti 2.6.2 Trajnimi i stafit të Drejtorisë Komunale të Arsimit për planifikim strategjik dhe operacional deri në gusht të vitit 2023.

Projekti 2.6.3 Hartimi i rregullores brenda shkollës deri në gusht të vitit 2023.

Objektivi specifik 2.7. Përmirësimi i cilësisë në menaxhim dhe mësimdhënie nëpërmjet vlerësimit sipas metodologjisë 360°, ku nxënësit vlerësojnë mësimdhënësit, mësimdhënësit menaxhmentin e shkollës, menaxhmenti i shkollës mësimdhënësit.

Projekti 2.7.1 Organizimi i vlerësimit të të gjitha niveleve prej prillit të vitit 2023.

Projekti 2.7.2 Analizimi i rezultateve, interpretimi i tyre dhe përgatitja për përmirësimet e mundshme deri në tetor të vitit 2023.

Projekti 2.7.3 Përzgjedhja e më të mirëve në mesin e nxënësve, mësimeve, drejtorëve të shkollave në qershor 2023. Të praktikohet çdo vit.

Projekti 2.7.4 Zhvillimi i partneritetit mes shkollave profesionale dhe bizneseve, në mënyrë që burimet njerëzore të aftësohen krahas kërkesës së bizneseve. Të praktikohet çdo vit.

Objektivi specifik 2.8. Ndërtimi i qendrës rezidenciale (administrata e shëndetësisë).

Projekti 2.8.1 Ndërtimi i qendrës rezidenciale.

Objektivi specifik 2.9. Ndërtimi dhe renovimi dhe i objekteve shëndetësore dhe oborreve të tyre.

Projekti 2.9.1 Ndërtimi i Qendrës Mjekësore Familjare (QMF) 3.

Projekti 2.9.2 Ndërtimi i Urgjencës së Qytetit.

Projekti 2.9.3 Renovim i objekteve shëndetësore.

Projekti 2.9.4 Rregullimi i oborrit të objekteve shëndetësore dhe shtimi i gjelbërimit.

Objektivi specifik 2.10. Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore në QKMF, AMF dhe AM.

Projekti 2.10.1 Blerja e autoambulancave.

Projekti 2.10.2 Furnizim me pajisje mjekësore.

Objektivi specifik 2.11. Ndërtimi i qendrës për persona të moshuar, përkrahja e tyre dhe familjeve në nevojë.

Projekti 2.11.1 Ndërtimi i qendrës për persona të moshuar.

Projekti 2.11.2 Ndihmë financiare për familjet në nevojë (1,200).

Projekti 2.11.3 Përmirësimi i kushteve të banimit së paku për 250 familje të identifikuar si raste sociale.

Qëllimi strategjik 3: Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i urbanizmit dhe infrastrukturës teknike

Objektivi specifik 3.1 Ndërtimi, zgjerimi dhe asfaltimi i rrugëve dhe infrastrukturës përcjellëse dhe mirëmbajtja e rrugëve të vjetra në periudhën strategjike.

Projekti 3.1.1 Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Skënderbeu" me infrastrukturë përcjellëse.

Projekti 3.1.2 Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës "Xhemail Mustafa" me infrastrukturë përcjellëse.

Projekti 3.1.3 Ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistranja Podujevë-Prishtinë deri në rrugën "Vëllezërit Frashëri" si dhe rrugën "Shaban Shala" me "28 Nëntorin".

Projekti 3.1.4 Asfaltimi i disa rrugëve dhe rrugicave nëpër lagjet e ndryshme të qytetit dhe zgjerimi i tyre.

Projekti 3.1.5 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Llapashticë.

Projekti 3.1.6 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Gllamnik.

Projekti 3.1.7 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Lupç.

Projekti 3.1.8 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shakovicë.

Projekti 3.1.9 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Sylevicë.

Projekti 3.1.10 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Majac.

Projekti 3.1.11 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Lluzhan.

Projekti 3.1.12 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Godishnjak.

Projekti 3.1.13 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Bellopojë.

Projekti 3.1.14 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Halabak.

Projekti 3.1.15 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Tërnavë.

Projekti 3.1.16 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Gërdoc.

Projekti 3.1.17 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Batllavë.

Projekti 3.1.18 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Kaçybeg.

- Projekti 3.1.19* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Orllan me rrethinë.
- Projekti 3.1.20* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shajkoc.
- Projekti 3.1.21* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Siboc.
- Projekti 3.1.22* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Balloc.
- Projekti 3.1.23* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Lladoc.
- Projekti 3.1.24* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Duminicë.
- Projekti 3.1.25* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Kërpimch.
- Projekti 3.1.26* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Zakut.
- Projekti 3.1.27* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Pakashticë.
- Projekti 3.1.28* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Bradash.
- Projekti 3.1.29* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Bajçinë.
- Projekti 3.1.30* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Tërnavicë.
- Projekti 3.1.31* Riparimi i rrugëve të asfaltuara.
- Projekti 3.1.32* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dobërdol.
- Projekti 3.1.33* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dobratin.
- Projekti 3.1.34* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dumosh.
- Projekti 3.1.35* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dyz.
- Projekti 3.1.36* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Herticë.
- Projekti 3.1.37* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Katunishtë.
- Projekti 3.1.38* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Konushec.
- Projekti 3.1.39* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Letanc.
- Projekti 3.1.40* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Livadhí.
- Projekti 3.1.41* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Llaushë.
- Projekti 3.1.42* Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Lluga.

Projekti 3.1.43 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Metehi.
Projekti 3.1.44 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Shtedim.
Projekti 3.1.45 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Penuhë.
Projekti 3.1.46 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Peran.
Projekti 3.1.47 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Pollatë.
Projekti 3.1.48 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Popovë.
Projekti 3.1.49 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Repë.
Projekti 3.1.50 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Revuq.
Projekti 3.1.51 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Sallabajë.
Projekti 3.1.52 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Sfeçël.
Projekti 3.1.53 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Surdull.
Projekti 3.1.54 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Surkish.
Projekti 3.1.55 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Zhiti.
Projekti 3.1.56 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Sllatinë.
Projekti 3.1.57 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Murgull.
Projekti 3.1.58 Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Reçicë.

Objektivi specifik 3.2 Ndërtimi i trotuareve dhe shtigjeve të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse.

Projekti 3.2.1 Ndërtimi i trotuareve në qytet dhe fshatra.

Projekti 3.2.2 Ndërtimi i shtigjeve të biçikletave.

Objektivi specifik 3.3 Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni, i kalesave të vogla në trotuare dhe i urave të vogla për këmbësorë.

Projekti 3.3.1 Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni.

Projekti 3.3.2 Ndërtimi i kalesave të vogla në trotuare.

Projekti 3.3.3 Ndërtimi urave të vogla për këmbësorë.

Objektivi specifik 3.4 Ndërtimi i urave me kalesa, i mureve mbrojtëse dhe meremetimi i rrugëve me zhavorr.

Projekti 3.4.1 Ndërtimi i urave me kalesa.

Projekti 3.4.2 Ndërtimi i mureve mbrojtëse.

Projekti 3.4.3 Meremetimi i rrugëve me zhavorr.

Objektivi specifik 3.5 Vendosja e shenjzimeve horizontale dhe vertikale.

Projekti 3.5.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese.

Projekti 3.5.2 Vendosja e shenjzimeve horizontale dhe vertikale.

Objektivi specifik 3.6 Ndërtimi i unazës së qytetit.

Projekti 3.6.1 Ndërtimi i unazës së qytetit.

Objektivi specifik 3.7 Ndërtimi i stacionit të autobusëve.

Projekti 3.7.1 Ndërtimi i stacionit të autobusëve.

Objektivi specifik 3.8 Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit.

Projekti 3.8.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese.

Projekti 3.8.2 Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në qytet.

Projekti 3.8.3 Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra.

Projekti 3.8.4 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në qytet.

Projekti 3.8.5 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatra.

Projekti 3.8.6 Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në qytet dhe fshatra.

Objektivi specifik 3.9 Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra.

Projekti 3.9.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të trupave ndriçues.

Projekti 3.9.2 Përpilimi i listës për ndriçim sipas prioritetit.

Projekti 3.9.3 Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik.

Objektivi specifik 3.10. Shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Projekti 3.10.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të lokaliteteve të pambuluara.

Projekti 3.10.2 Përpilimi i listës prioritare për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Projekti 3.10.3 Rritja e mbulueshmërisë me shërbime për mbeturina rreth 90%, deri në fund të vitit 2025.

Projekti 3.10.4 Largimi i deponive ilegale dhe rikultivimi i tyre me gjelbërim/barë.

Projekti 3.10.5 Identifikimi i mundësisë për asgjësimin e mbeturinave medicinale në nivel rajonal ose brenda spitalit.

Projekti 3.10.6 Ndarja e mbeturinave në burim.

Projekti 3.10.7 Kompostim individual.

Objektivi specifik 3.11. Përmirësimi i shërbimeve të efijencës së energjisë.

Projekti 3.11.1 Aplikimi i masave të EE-së në ndërtesën e komunës.

Projekti 3.11.2 Aplikimi i masave të EE-së në ndërtesën e Qendrës së punës sociale.

Projekti 3.11.3 Aplikimi i masave të EE-së në ndërtesa shkollore (SHFMU: "Shaban Shala", "Drita", "Musli Dumoshi", "Ali Hadri", "Shefki Kuleta", "Kadri Kadriu", "Shefki Latifi", "Emin Duraku", "Ilir Konushevi", "Jetullah Islami").

Projekti 3.11.4 Aplikimi i masave të EE-së në ndërtesa shëndetësore.

Projekti 3.11.5 Aplikimi i masave të EE-së në ndriçimin publik.

Objektivi specifik 3.12. Ndërtimi i parkingut nëntokësor.

Projekti 3.12.1 Ndërtimi i parkingut nëntokësor.

Qëllimi strategjik 4: Zhvillimi i turizmit nëpërmjet promovimit të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit të pastër jetësor

Objektivi specifik 4.1 Përmirësimi i infrastrukturës së turizmit dhe rekreacionit.

Projekti 4.1.1 Investim në infrastrukturë të turizmit.

Projekti 4.1.2 Ndërtimi i terreneve sportive dhe rekreacionit.

Projekti 4.1.3 Ndërtimi i palestrës së qytetit.

Projekti 4.1.4 Ngritja e qendrës informative/promovuese të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Projekti 4.1.5 Shenjëzimi me tabela informuese vlerave të trashëgimisë kulturore.

Projekti 4.1.6 Shenjëzimi i drejtimeve rrugore që çojnë drejt monumenteve të trashëgimisë.

Objektivi specifik 4.2 Ndërtimi dhe rritja e hapësirave të parqeve, hapësirave të reja të gjelbëruara, kopshteve të hapura të lodrave për fëmijë.

Projekti 4.2.1 Ndërtimi i parkut 1..

Projekti 4.2.2 Ndërtimi i parkut 2.

Projekti 4.2.3 Ndërtimi i parkut 3.

Projekti 4.2.4 Rregullimi i parkut të paqes.

Projekti 4.2.5 Rritja e hapësirave të parkut ekzistues 1.

Projekti 4.2.6 Rritja e hapësirave të parkut ekzistues 2.

Projekti 4.2.7 Rritja e hapësirave të parkut ekzistues 3.

Projekti 4.2.8 Ndërtimi i kopshtit të hapur të lodrave për fëmijë 1.

Projekti 4.2.9 Ndërtimi i kopshtit të hapur të lodrave për fëmijë 2.

Projekti 4.2.10 Ndërtimi i kopshtit të hapur të lodrave për fëmijë 3.

Objektivi specifik 4.3 Zhvillimi i turizmit nëpërmjet promovimit të trashëgimisë kulturore, resurseve natyrore, peizazheve.

Projekti 4.3.1 Përgatitja e broshurave informuese, deri në qershor të vitit 2023.

Projekti 4.3.2 Promovimi i turizmit.

Projekti 4.3.3 Promovimi i trashëgimisë kulturore.

Projekti 4.3.4 Promovimi i Liqenit të Batllavës.

Projekti 4.3.5 Promovimi i atraksioneve turistike të komunës në platformat më të njohura online.

Objektivi specifik 4.4 Ndërtimi, renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore.

Projekti 4.4.1 Monumente kulturore.

Projekti 4.4.2 Renovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore.

Projekti 4.4.3 Revitalizimi i vlerave të trashëgimisë arkitekturore në funksion të zhvillimit turistik (Mulliri në Majac, Kulla e Xhemail Haxhiut).

Objektivi specifik 4.5 Ndërtimi i objekteve të reja kulturore dhe argëtuese dhe funksionalizimi i atyre ekzistuese.

Projekti 4.5.1 Ndërtimi i muzeut të qytetit.

Projekti 4.5.2 Ndërtimi i shtëpisë së kulturës.

Projekti 4.5.3 Funksionalizimi i kinemasë së qytetit.

Projekti 4.5.4 Pasurimi i bibliotekës së qytetit me 10,000 tituj librash.

Objektivi specifik 4.6 Pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore.

Projekti 4.6.1 Mbjellja e drunjëve.

Projekti 4.6.2 Ripyllëzimi i hapësirave të zhveshura.

Objektivi specifik 4.7 Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe ruajtja e mjedisit.

Projekti 4.7.1 Mirëmbajtja e vazhdueshme e sipërfaqeve të gjelbëruara.

Projekti 4.7.2 Parandalimi i prerjes ilegale të pyjeve.

Projekti 4.7.3 Krijimi i shtabit të emergjencës në rast të paraqitjes së zjarreve në pyje.

Objektivi specifik 4.8 Zgjerimi, rregullimi dhe mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve.

Projekti 4.8.1 Zgjerimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve.

Projekti 4.8.2 Mirëmbajtja e brigjeve të gjithë lumenjëve.

Projekti 4.8.3 Mirëmbajtja e shtratit të liqenit Batllava.

Projekti 4.8.4 Mbjellja e fidanëve pyjore në brigjet e lumenjve.

Projekti 4.8.5 Largimi i barrierave nga shtrati i lumenjve, qofshin ato natyrale apo të krijuara nga njeriu.

Projekti 4.8.6 Kontrollimi i zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve.

Projekti 4.8.7 Masat përkatëse për mbrojtjen e botës bimore, peizazhit në brigjet e lumenjve.

Qëllimi strategjik 5: Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i funksionalitetit dhe efikasitetit të shërbimeve komunale

Objektivi specifik 5.1 Investimi në infrastrukturë publike

Projekti 5.1.1 Blerja e pajisjeve dhe materialit shpenzues për nevoja të komunës.

Projekti 5.1.2 Blerja e automjeteve për nevoja të komunës.

Objektivi specifik 5.2 Shërbime cilësore, efikase dhe transparente për qytetarët dhe bizneset

Projekti 5.2.1 Informimi i qytetarëve dhe bizneseve në kohë për format e shërbimeve komunale.

Projekti 5.2.2 Përditësimi i informatave në uebfaqen komunës, për shërbimet e ofruara dhe dokumentet e nevojshme.

Projekti 5.2.3 Publikimi i rregullt i raporteve gjashtëmujore, vjetore si dhe raporteve tjera relevante të punës, në uebfaqe të komunës.

Projekti 5.2.4 Matja e kënaqshmërisë së qytetarëve/bizneseve për shërbimet e ofruara komunale (*pyetësor online*).

Objektivi specifik 5.3 Digjitalizimi i administratës.

Projekti 5.3.1 Digjitalizimi i lëndës arkivore.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal 2023-2025 e komunës së Podujevës ndërthen në vete edhe planin e zbatimit (*shih shtojcën 1*) që përfshin periudhën 2023-2025. Ky plan i zbatimit përbëhet nga aktivitetet, afati i zbatimit të tyre, kostoja totale, burimi i financimit dhe institucionet udhëheqëse dhe përgjegjëse.

Ky plan i zbatimit do të rishikohet në baza vjetore në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në strategji. Struktura për monitorimin e zbatimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal përbëhet nga indikatorët matës, të cilët janë të vendosur në nivel të objektivave specifike në SZHEL.

Rrjedhimisht, komuna e Podujevës do të monitorojë dhe vlerësojë nëpërmjet raporteve të rregullta, nëse janë arritur rezultatet e synuara. Po ashtu, komuna do të përqendrohet në vlerësimin e fushave të caktuara në lidhje me rëndësinë, efikasitetin, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e planit strategjik. Prandaj, komuna do të fillojë një vlerësim afatmesëm në vitin 2024 dhe përsëri në fund të periudhës strategjike në vitin 2025. Duhet theksuar se vlerësimi i projekteve dhe programeve do të vazhdojë gjatë gjithë periudhës strategjike.

NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së aktiviteteve: Plani i veprimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2023-2025 për komunën e Podujevës, ka një kosto totale të zbatimit prej 41,094,784 €.

Burimet e financimit të strategjisë: Financimi i zbatimit të planit të veprimit të kësaj strategjie, parashihet të bëhet nga buxheti i komunës së Podujevës, grantet qeveritare, donatorët etj.

SHTOJCA 1

Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SZHEL

Qëllimi strategjik #1: Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i qëndrueshmërisë ekonomike

Objektivi specifik 1.1	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
Subvencionimi i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme që merren me bujqësi, (drithëra, pemdtari dhe perimtari), blegtori dhe bletari	1.1.1 Përkrahje financiare për ngritjen e pemishteve	2023-2025	300,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministrinë relevante
	1.1.2 Përkrahje financiare për furnizimi me fidanë të pemëve të imëta si mjedër, dredhaz dhe manaferrë	2023-2025	150,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministrinë relevante
	1.1.3 Përkrahje financiare për ngritjen e serave të perimeve	2023-2025	490,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministrinë relevante
	1.1.4 Përkrahje financiare për kultivimin e kulturave lavértare	2023-2025	100,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministrinë relevante
	1.1.5 Përkrahje financiare për ngritjen e fidanishteve dhe lulishteve	2023-2025	60,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministrinë relevante
	1.1.6 Përkrahje financiare në kultivimin e bimëve, çajrave mjekuese kërpuhave	2023-2025	60,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministrinë relevante
	1.1.7 Krjimi i fondit për subvencionimin e shpenzimeve të interesit për kreditë investive në zgjerimin e kapaciteteve	2023-2025	-€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës,

SHTOJCA 1

Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

prodhuese					Bankat komerciale
1.1.8 Përkrahje financiare fermerëve në përpunim të prodhimeve bujqësore	2023-2025	300,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante
1.1.9 Ndërtimi i pikave grumbulluese të qumështit	2023-2025	100,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante
1.1.10 Ndërtimi i fabrikës për përpunimin e qumështit	2023-2025	100,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante
1.1.11 Përkrahje financiare fermerëve për ndërtimin e fermave me 15 krerë lopë përfshirë mekanizmin bujqësor	2023-2025	100,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante
1.1.12 Përkrahje financiare fermerëve për ndërtimin e fermave deleve, dheneve, shpezëve përfshirë mekanizmin bujqësor	2023-2025	100,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante
1.1.13 Ngritja e shoqërive të bletëve (50 shoqëri e më shumë bletësh)	2023-2025	30,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante
1.1.14 Përkrahja e fermerëve e ndërtimin e mjeteve të vjetërsuara të punës, sidomos mekanizmave bujqësorë	2023-2025	320,000€	Komuna e Podujevës, donatorët	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante, donatorët
1.1.15 Ndërtimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore në luginën e lumit Ulap	2023-2025	600,000€	Komuna e Podujevës, donatorët	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante.

SHTOJCA 1

Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

Objektivi specifik 1.2	Aktiviteti/Projekti	Afati i zbatimit	Kostoja totale	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës	Institucioni mbështetës
						donatorët
	1.1.16 Ndalimi i tjetërsimit të tokës cilësore bujqësore nga zhvillimet sipas dispozitave ligjore	2023-2025	/	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante
	1.1.17 Ndalimi i ndotjes së tokës bujqësore nga ndotësit e ndryshëm sipas dispozitave ligjore	2023-2025	/	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante
	1.1.18 Përkrahja e fermerëve dhe bujqve me trajnime	2023-2025	/	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës, ministritë relevante
	1.1.19 Organizimi i panairëve me qëllim të promovimit të prodhimeve lokale	2023-2025	40,000€	Komuna e Podujevës	Komuna e Podujevës	Ministritë relevante
